

**UNITED
NATIONS**
United Nations Interim
Administration Mission
in Kosovo



NATIONS UNIES
Mission d'Administration
Intérimaire des Nations
Unies au Kosovo

GOVERNMENT

PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF

**KUVENDI I KOSOVËS
СКУПШТИНА КОСОВА
ASSEMBLY OF KOSOVO**

**DËGJIM PUBLIK
I KOMISIONIT PËR ARSIM, SHKENCË,
TEKNOLOGJI, KULTURË, RINI DHE SPORT**

**Prishtinë,
më 24.4.2007**

**KOMISIONI PËR ARSIM, SHKENCË, TEKNOLOGJI,
KULTURË, RINI DHE SPORT**

KRYETARI ENVER HOXHAJ – A mund të fillojmë? Të nderuar zonja dhe zotërinj, të nderuar përfaqësues të SBASHK-ut, të nderuar kolegë.

Sot Komisioni për Arsim Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini dhe Sporte në përputhje me letrën e hapur, e cila është formuluar nga Sindikata për Arsim e Kosovës, drejtuar udhëheqësve të institucioneve të Kosovës, organizon këtë dëgjim publik me qëllim që vërtet t'i dëgjojmë brengat, shqetësimet, kërkesat të cilat i ka Sindikata e Arsimit Kosovar sa i përket gjendjes mjerueshme e cila është arsim. Ju e dini që dëgjimet publike nuk janë shumë të thirrura që deputetët të japin vlerësim për gjendjen në arsim, po janë të gjitha të menduara në atë formë që ata të cilët ftohen t'i shprehin shqetësimet e tyre.

Më lejoni që vetëm në emër të Komisionit në bazë të shkresës që ne kemi marrë nga SBASHK-u e kemi pa të udhës që ta kem një dëgjim publik të kësaj natyre meqë argument të cilat u afron SBASHK-u janë jashtëzakonisht prekëse dhe jashtëzakonisht thelbësore për gjendjen e arsimit në Kosovës. Prej asaj se ngitet shqetësimi rreth dështimit të projektit për nivelizimin e pagave në përgjegjësi e cila në një formë tjetër bëjnë edhe mbi Kuvendin e Kosovës deri rreth asaj se si ndodh vlerësimi i rezultateve të diturisë, dilema e ngritur ose konstatimi për mungesë të transparencës në vlerësimin e diturisë, ankesat që i kanë prindërit, një përshtypje e cila shpeshherë ka të bëjë edhe me një vlerësim subjektiv deri në vlerësimin edhe se strategjia e MASHT-it për zhvillimin e arsimit deri në vitin 2017 shihet më tepër si një retorikë se sa diçka tjetër. mandej vlerësimet të cilat referohen edhe në reduktimet të kuadrit edhe të hapësirës me shembuj konkret që ka të bëjë edhe me arsimin parashkollor, ne kemi miratuar në Kuvendin e Kosovës një Ligji për arsimin parashkollor i cili me të vërtetë është ligj modern i cili parasheh që arsimi parashkollor të jetë obligativ, mirëpo ajo se çfarë ndodh në pushtetet komunale dhe kuvendet komunale është e kundërta ku shumë paralele shkollore veç mbyllen. Shqetësimet të cilat janë thelbësore që kanë të bëjnë me çështjen e politizimit të arsimit në mënyrë se si zgjidhen drejtorët ose udhëheqësit e institucioneve arsimore, çështjen e largimit të kuadrove mësimorë, dhe mbi të gjitha me probleme konkrete që kanë të bëjnë me mungesën e hapësirës shkollore. Me konstatimin që klasat janë të stërngarkuara ku ka klasë të cilat 45 nxënës janë në një paralele ku 3-4 nxënës ulen në një bankë, ku ora mësimore zgjatë po thuaj se 30 minuta. E gjithë ky konstatim i cili le përshtypjen që a jem t'u fol për një sistem arsimor i cili i takon vitit 2007, apo jem t'u fol për diçka çka i takon historisë.

Mandej edhe me shqetësime konkrete që kanë të bëjnë me trajnim e mësuesve të cilat trajnime kanë zgjatë vetëm 2 – 3 ditë. Përveç kësaj dilema shumë konkrete e ngritur që një pjesë e madhe e nxënësve fillojnë klasën e parë të shkollës fillore dhe të tretën rrugë e sipër dhe nuk arrin asnjëherë në klasën e nëntë ose në përfundim të ciklit është një dilemë që e shtron nevojën për një debat mirëfilltë se sa njerëz lëshojnë shkollën fillore dhe shkollën e mesme, pse e lëshojnë këta të rinj dhe sidomos të reja në zonat rurale shkollën, fenomenet e konsumimit të drogës dhe të alkoolit, huliganizmit në shkollë, çështjet që kanë të bëjnë edhe me arsimin privat dhe mbi të gjitha edhe çështjet që lidhen me fenomenin se sa respektohet gjuha e standardizuar në shkollë, tekstet shkollë dhe në media në Kosovë. Gjitha këto janë konstatime. Unë nuk jam i thirrur që t'i lexoj kërkesat

të cilat i ka SBASHK-u nëpër të gjitha këto konstatime për ne si Komision për arsim kanë shërbyer si bazë që ta organizojmë këtë dëgjim publik.

Komisioni për Arsim disa herë ka mund t'i vizitoj disa prej shkollave fillore, shkollave të mesme në rajonet e ndryshme të Kosovës, në qytete dhe në fshatrat e ndryshme, shqetësimet të cilat SBASHK-u i ngrit janë përshkrim dhe reflektim preciz i saj dhe ne si Komision se çfarë kemi bërë.

Të nderuar përfaqësues të SABSHK-ut, në një drejtim të tillë kemi organizuar në përputhje me kërkesën e juaj këtë dëgjim publik. Ju ftojme që firmë sindikaliste t'i shtroni problemet të cilat juve ju mundojnë dhe mbi të gjitha ne do të mundohemi që në frymë parlamentare dhe në fuqi parlamentare në përputhje me mandatin që ka ky Komision dhe me përgjegjësi dhe kompetenca që ka ky Komision më tutje ta shtymë këtë katalog të shqetësimeve të cilat ju i keni ngritë para udhëheqësve të institucioneve të Qeverisë në Kosovë.

Sipas natyrës e ftoj kryetarin e SBASHK-ut, sipas natyrës të dëgjimeve publike që t'i prezanton shqetësimet e tija në emër të SBASHK-ut, mandej i çdo këndë që i është i pranishëm që të kontribuojë në këtë dëgjim publik dhe kuptohet që në fund të dëgjimit publik kolegët e mi të nderuar secili prej tyre munde të shtron pyete ose të jep edhe vlerësime individuale konkrete për gjendjen të cilën përshkruhet në këtë shkresë të SBASHK-UT.

Më lejoni që ne kemi qenë shumë favor që këtë edhe një seancë të veçantë për arsimin fillor dhe të mesëm, seanca e cila do të duhej të ndodhë deri në fund të kësaj javës, jem pakës të habitur pse nuk është në agjendë ditore, mirëpo jam shumë i siguritë që edhe pse jem komision shumë partiak çdo kush që është këtu i pranishëm është i interesuar që çështjen e arsimit ta sjellë në seancë të Kuvendit të Kosovës dhe besoj që në fund të këtij takimit përveç kërkesave të tilla të natyrës tekniko do të mundohemi që të jem në dispozicion të juaj edhe në rrafshin afatshkurtra adresimit të disa problemeve të cilat ju mundojnë.

Nëse dikush prej anëtarëve të Komisionit nuk ka të shtojë diçka paraprakisht, unë ia kisha dhanë fjalën kryetarit të SBASHK-ut Ali Shabanit.

ALI SHABANI – Faleminderit. z. kryetar. Të nderuar deputetë. Kam nderin dhe kënaqësinë që së bashku me ekipin e SBASHK-ut në përbërje, nuk po di a t'i prezantoj, apo do të prezantohen vet, se jemi bukur shumë, ndoshta është më mirë t'i prezantoj. Në krahun e djathtë timin është prof. Xhafer Xhaferi, nënkryetar i SBASHK-ut, pastaj pranë tij Bislim Berani, është koordinator i rajonit të Prishtinës, Besnik Krasniqi është kryetar i Sindikatës së Arsimit të mesëm të Kosovës, Lutfi Mani, është nënkryetar i SBASHK-ut, Nezir Gashi është kryetar i SBASHK-ut për Prishtinën. Në krahun e majtë është Mehdi Grapci, nënkryetar i SBASHK-ut, Zenel Zeka është sekretar gjeneral i SBASHK-ut, profesor Qerim Selim, kryetar i SBASHK-ut për Universitetin dhe institucionet shkencore dhe Rrahman Jashari është kryetar i Arsimit Fillor të SBASHK-ut.

Ne para pak ditësh ju kemi drejtuar institucioneve tona dhe juve normalisht me letër të hapur, në të cilën letër, siç tha kryetari kemi shpreh shqetësimin tanë për pozitën e arsimit në këto vite, në vitet e pasluftës. Në kohën kur mendonim që vërtetë arsimi do të jetë prioritet i Qeverisë tonë dhe arsimi do të përjeton një ringjallje të plotë, megjithatë kujtojmë se ajo punë nuk është bërë sa duhet. Nuk ka angazhime të mirëfillta. Pikërisht në Parlamentin e Kosovës një seancë për arsimin ishte në vitin 2003, në korrik më sa më kujtohet ku deputetët e nderuar të legjislaturës së parë shprehën shqetësimet e tyre por e tëra mbeti në shqetësime dhe jo në veprime konkrete për të normalizuar sistemin e arsimit për të ruajtur dinjitetin e mësimdhënësit për të ndërruar pozicionin e tij dhe për të përmirësuar pozicionin materiale të punëtorit të arsimit dhe në nivele të ndryshme të arsimit në përgjithësi në sistemin publik të Kosovës.

Ne tani duke përcjell punën kemi dal me shqetësime tona atë e kemi adresuar posaçërisht te ju, nga se kujtoj ju jeni persona më të merituar të cilët duhet të angazhoheni për procesin e arsimit, për sistemin e arsimit, por edhe për sistemin e arsimit privat për ato që ndodhin sot në Kosovë, për të ndryshuar, për të krijuar një sistem vlerash, një sistem kompatibil me sistemet arsimore të Evropës, me qëllim që vërtetë të kem për çka të krenohem, të kemi çka i afrojmë Evropës dhe botës kulturën, traditën, arsimimin dhe profesionalizmin tonë. Fatkeqësisht deri më tani nuk mund të mburrem se kemi bërë ndonjë mrekulli në këtë punë. Ka ndryshime pozitive se nuk mund t'i hedhim poshtë ato, por megjithatë nuk janë bërë ato që i kërkon ky popull, ato që i kërkon rinia jona, një rini e shëndetshme e shëndoshë dhe rini që ka një perspektivë dhe sot mund të themi se mund ta shtrojmë çështjen se cila është perspektiva e asaj rinie tonë.

Pikërisht unë s' do të ndalem shumë në detaje të flas për këto, se kolegët e mi do të flasin çdonjëri për çështje të veçanta dhe shqetësimet që vinë nga rajonet e ndryshme të Kosovës, por do të përpiqem t'i zbërthej pak ato katër kërkesa që në mënyrë të përmbladhura do të zbërthehen për çështje që janë me interes për ne në përgjithësi.

Siç e dini pozita materiale e punëtorëve të arsimit është një nga çështjet kryesore të cilat po themi dhe po e degradojnë sistemin e arsimit dhe po e rëndojnë realizimin e formës së arsimit edhe nuk po krijojnë vlera të mirëfillta ngase duhet stimuluar atë dhe duhet paguar për punën që e bën. Këtë kuptim që nga paslufta e deri më tani janë bërë shumë pak përpjekje për të ndryshuar pozitën materiale të punonjësve të arsimit në nivele të ndryshme arsimore. Unë kam arritë këtu t'i kem edhe disa shënime dhe t' ju themi se ato ndryshime janë shumë të vogla, të parëndësishme dhe pak e kanë ndryshuar jetën e tyre. Pak iu kanë mundësuar që ata të shfletojnë literaturë shkencore për të qenë të përgatitur për orët e tyre të mbajtura. Pak jep mundësi që të jem më kreativ në procesin mësimor, pak ka ndryshime pozitive nga më përpara. Të themi gati se në pjesë dërmuese të shkollave tona mësuesit i ka mbetë shkumësi, dërrasa e zezë dhe librat që përdoren, doracakët e ndryshëm, qoftë për mësimdhënës, qoftë edhe librat shkollorë të nxënësve. Të gjitha këto nuk janë garanci se sistemi i arsimit do të jetë sistem vlerash dhe sistem që ne e presim në përgjithësi.

Kur flasim për pagat vërtetë ato kanë lëviz shumë pak. Në periudhën e pasluftës deri tani pagat në sistemin e arsimit janë ngritë në vlerën 25%. Kjo në masën kur kanë filluar të

ngritën nga 145 euro dhe 156 euro kjo është shumë e parëndësishme. Dhe tani pagat e mësuesve janë këto.

Në arsim fillor një mësues e ka pagën flas në neto 180.50 euro. Profesori i shkollës së mesme 196.82, drejtori i shkollës fillore 233.23, drejtori i shkollës së mesme 249.91 cent. Profesori ordinar pas rritjes në grevën që e realizuam në vitin 2005 ka arritur në 442.26 cent. Këto janë paga që merren nga buxheti i Kosovës. Profesori i asocuar 370.47, asistent profesor 341.39, ligjëruesi 246. dhe asistenti dhe tash janë nda dy kategori të asistentëve, asistenti dhe asistenti i ri 234.14.

Me vet fakti se këto shifra dëshmojnë të arriturat ose mos të arriturat në sistemin e arsimit. Këto nuk janë vlera të shprehura nga mundi dhe sakrifica e tyre. Nuk është vlerë reale e shprehur në mjete dhe pikërisht këtu është pengesa se sa do të realizohet reforma e arsimit pa mbështetje financiare dhe pjesa dërmuese në punojmë në arsim dhe keni punuar në arsim edhe ju të nderuar deputetë dhe keni parë se vërtetë gjendja nuk është ajo që ne e dëshirojmë.

Nëse bëjmë një digresion me institucionet tjera, unë nuk po e përmendi institucionin, por bie fjala në një institucion të Kosovës nga viti 2002 deri në vitin 2007 paga ose rritja në përqindje është 98% dhe shtrohet pyetja mbi cilën bazë, mbi bazën 511 euro dhe kjo është bazë dhe dyfishi i kësaj bënë gati 1000 euro mos të them 980 euro. Pa i alarmuar ato privilegje të tjera që vinë, punët e angazhimit që janë shumë normale për këtë institucion që unë po e zë në gojë pa e përmend emrin e institucionit fare. Megjithatë, ngritje të pagave ka edhe në institucione të tjera. E marrim SHPK bie fjala, nga majori deri në gjeneral janë rrit pagat. Nuk kam reaguar dhe ju i dini se gjenerali e ka pagën diku 870 – 880 euro nuk di saktësisht veç e di se këtu përafërsisht. Do me thanë është një rritje që ne nuk kemi reaguar ngase ata kanë përgjithësi. Megjithatë unë kujtoj se edhe mësimdhënësit kanë përgjithësi pikërisht në punën e tyre. Ata e krijojnë të ardhmen e Kosovës dhe produkti më i rëndësishëm është produkti që vjen nga arsimi. Nëse kjo nuk është, atëherë nuk do të kishim biseduar fare për këtë punë

Çështje tjetër që ngritët në këtë plan është a thua, a më mirë të veprohet në mënyrë preventive apo të shërohet? Shërimi do të kushton shumë më shtrenjtë se sa preventiva. Do të ishte shumë më mirë që në mënyrë preventive të veprohet, të caktohet një pagë reale për një ekzistencë normale të punëtorit të arsimit dhe të kërkohet punë më shumë nga ai. Akoma më shumë punë ngase dorën në zemër nuk po bëjnë punë sa duhet me bërë. Nuk jemi të kënaqur me punën dhe kreativitetin e mësimdhënësit në sistemin e arsimit në Kosovë, sistemin e arsimit publik s'po flas për arsimin privat.

Këto janë disa shqetësime në çështjen e pagave dhe mendoni se paga e shtuar 7 euro ishte vërtet një shpullë arsimtarit, një degradim i personalitetit të tij. Mos të them edhe diçka tjetër se më vjen keq të shprehna ,por vërtet duhet menduar më shumë. Ne po bëjmë përpjekje këtu t' ju japim informacione me qëllim që ju të jeni më të suksesshëm në mbrojtjen e interesave të arsimit në përgjithësi, se mbrojtja e interesave të arsimit është mbrojtja edhe e interesave të juaja dhe kujtoj se në këtë plan duhet të realizohet kjo.

Meqë kolegët e tjerë do të flasin më shumë për këtë çështje, na kemi edhe çështje tjera të cilat i kemi ngrit. Një nga çështjet kryesore është edhe kushtet e punës. Kryesisht në qendrat urbane ekziston një ngarkesë e shkollave me nxënës, punohet në 3-4 ndërrime dhe mëreni me mend se çfarë pune dhe çfarë suksesi arrihet aty. Aty është një zhurmë e madhe, një ndërrim nderimesh të themi ashtu, një lëvizje që nuk din kush hyn dhe kush del dhe duhet bërë përpjekje që nga shërbimet dhe mallrat edhe pse buxheti për Ministrinë e Arsimit është rrit vitin e kaluar pak që të bëhen përpjekje që pikërisht në viset urbane të ngritën edhe shkolla të reja, me qëllim që të shkarkojnë atë numër të madh të nxënësve ,siç u përmend edhe në atë letërën e hapur që ju kemi dërguar.

Unë kujtoj se përveç objekteve që nuk i plotësojnë kushtet dhe tash kur bëhet ndarja e ciklit të ulët, shkollës së mesme të ulët, aty do të krijon edhe probleme të reja edhe administrata do të shtohet me punëtorë të ri dhe problemet do të jenë akoma më të mëdha. Një problem tjetër është edhe pajisja e dobët e shkollave me kabinete. Në shumë shkolla kanë mbet kabinetet që ishin më përpara. Duke përjashtuar kabinetet informatike se kjo është një lëndë e re që ne përpara nuk e kemi pas dhe normalisht se ajo lëndë ka avancuar me kabinetet dhe me kompjuterë që i kanë. Ndërkaq, lëndë të tjera. aty -këtu janë bërë ndryshime pozitive kryesisht në arsimin profesional në shkollat e mesme profesionale teknike, ekonomik. Janë ndryshime pozitive që s'mund të mohohen, por shumë pak janë bërë në gjimnaze dhe në shkolla tjera të përgjithshme të cilat vërtet kërkojnë një ndryshim po them radikal në të mirë për mësim nxënie më të suksesshme dhe mësimdhënie akoma më të suksesshme.

Problem tjetër që kemi ngrit aty është edhe problemi i sigurimit shëndetësor. Meqë kem sot një dëgjim publik në legjislativin e Kos, ju lutem pushimi shëndetësor është 15 ditë, 15 ditë është pushimi i paguar, e çka pas? Ne fatkeqësisht kemi mësimdhënës të cilët kanë përjetuar sëmundje të ndryshme, qoftë profesionale e të tjera dhe sot kanë betë jashtë procesit mësimor. Nuk iu ka dhënë mundësia që ata të shërohen dhe të kthehen në procesin mësimor, është një shqetësim shumë i madh që kujtoj kolegët e mi më profesionale do ta shtojnë dhe do të ishte mirë që të merremi maksimalisht me këtë që të na lehtësoni punën duke e ditur se vjetërsia e punëtorit të arsimit është bukur e madhe, mesatarja është 20 – 25 vjet përvojë pune dhe kjo është një mesatare, të themi gati mbi mesatare. Qëllimi dhe synimi ynë është që të shkohet drejt rregullimit të kësaj çështje, por njëkohësisht do të ishte me interes për rininë e Kosovës që mosha e pensionit të ulët së paku për 5 vite për t'i dhënë mundësi të rinjve të inkuadrohen. Përndryshe, ne prodhojmë kuadro dhe ata vërtetet rrugëve pa perspektivë . Duhet ju në Kuvendin e Kosovës të mendoni për këtë çështje se është çështje për rininë e Kosovës dhe për të ardhmen e këtij vendi.

Ne kemi shprehë shqetësimin edhe për Ligjin e arsimit. Ne kujtojmë se ai ligj nuk i plotëson kriteret të jetë një ligj i mirë i arsimit në Kosovë Arsimi fillor dhe i mesëm. Ne e kemi marrë, jemi duke punuar. E kemi kontaktuar me Ministrinë e Arsimit që të propozojmë ndryshime në amendamentet e reja që do ta bënte atë ligj më praktikë. Prandaj, kujtoj se prapë kolegët e mi do të ndalën më konkretisht dhe do të flasin se cilat janë ato objektivat tona për ndryshimin e këtij ligji.

Flitet për reformë. Reforma e ka arrit fundin, do me thënë sivjet përfundimisht përfundon reforma vitin që vjen, do me thënë viti i pestë në atë kuptimin dhe reforma si e tillë përfundon. Shtrohet pyetja. A është realizuar suksesshëm? Ne në aspektin numerik e kemi realizuar atë. Do me thanë e kemi përmbyll një cikël, por çka pas saj? Duhet ndalur dhe të bëhet një analizë e mirëfilltë se cilat janë defektet e reformës, çfarë duhet ndryshuar? Si duhet të mbështetet reforma? A të mbështetet në aspektin financiar në forma të tjera, qoftë në përmirësimin e kushteve të punës ose edhe me elemente të tjera që atë e bëjnë më përmbajtjesore?. Prandaj, reforma është një çështje shumë me interes. Ne e realizuam për disa arsye.

Një, të gjithë mësimdhënësit kishin dispozicion për ndryshime në sistemin e arsimit. Ishin të gatshëm ta ndryshojnë edhe veten. Madje edhe ai person që kishte 65 vite, do me thanë ndryshime pozitive, po them gati substanciale në qenien e vet mësimdhënësit, por a mjafton ajo? A mjafton ajo pa shtytje, pa nxitje, pa stimulim. Me vetë faktin se punëtorët e arsimit në nivelin e arsimit fillor dhe të mesëm paguhën në mënyrë lineare, kjo është demotivuese për të gjithë, marrin një lloj, të gjithë .Nuk kontrollohen, nuk ka një vlerësim të brendshëm dhe vlerësim të jashtëm adekuat për punën dhe kreativitetin e tyre në procesin mësimor. Kjo vërtet nuk ka kuptim pas 7-8 vitesh të bëhen ndryshime... Si duket, ne jemi duke fjetur në disa segmente të sistemit të arsimit në përgjegjësi. Prandaj, duhet bërë ndryshime.

Çështje tjetër është edhe çështja e statusit të mësimdhënësve. Edhe sot e kësaj dite mësimdhënësi përballet me një kontratë njëvjeçare, pavarësisht nga kualifikimi që i ka dhe 31 gushtin e pret në ankth, me shpresë ose pa shpresë se do të vazhdon ose do të mbetet jashtë, se kontrata është njëvjeçare.

Ne kemi kërkuar nga Ministra e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë që të bëhet licencimi. Edhe me strategjinë është paraparë që ai të fillojë në vitin 2008, por dje me një takim me ministrin e Arsimit jemi marrë vesh që si pilot-projekt në këtë viti licencimi i mësimdhënësve ,sipas kriterëve që ka hartuar Ministria e Arsimit, do me thanë kriteri është bazë e atij kriteri do t'i referohem të gjithë. Duhet të fillojë një herë të stabilizohet se kjo është një element i stabilizimit të procesit mësimor. Njerëzit nuk do të mendojnë se njerëzit nuk do të mendojnë se do të kalojnë diku tjetër, se e kanë vendin e tyre të punës, jo punë një vjeçare, por punë shumëvjeçare, për ata që i plotësojnë kriteret.

Ne na shqetësojnë edhe shumë probleme tjera, Bie fjala, shumë shqetësuese ishte përpjekja e KEK-ut për ngritjen e energjisë elektrike dhe tash edhe ma shqetësuese përpjekja për subvencionimin e energjisë elektrike nga Qeveria. Kënd do ta paguan Qeveria, rrymën që e harxhojmë ne, jo Le të na i ngrit pagat se na e paguajmë rrymën vetë. Ky është problemi. Prandaj, nuk është kjo çështje që bëhet kështu tek e fundit, merr paratë këtu dhe hodhi atje dhe Qeveria nuk ka nevojë me pagunë paratë për rrymë, ka nevojë të na i paguan për punën tonë dhe ne do ta paguajmë vetë.

Çka kemi kërkuar tjetër? Ne kemi hartuar një shportë mujore atje, ndoshta s'ia kemi qëlluar, ju e keni atje. Me siguri nuk ia kemi qëlluar se nuk i kemi shënuar të gjitha çmimet për të gjitha kërkesat që i ka një njeri normal dhe kemi në fund. Nuk kemi

dashur të kërkojmë rritjen e pagave në përqindje se e dimë se do të dalim humbës, por kem dashtë me tregu se një shportë për një familje për 6 anëtarësh bile një shportë pa ato gjërat elementare, pa literaturë profesionale, pa teatër ,pa të gjitha ato,pa qiratë e shtëpisë, të gjithë i kemi shtëpitë tona tjera e tjera,po” them “ se gjysma s’i kanë etj. I kem paraqit atje.

Këtë shportë le ta harton kush donë edhe Enti Statistikor i Kosovës le ta harton, me siguri nuk do të gjen ndonjë çmim më të ulët atje, por nëse e gjen le ta gjen,nuk ka problem dhe kjo shportë është një element se do t’ju jep mundësi juve që vërtetë kërkonit që arsimit vërtet të jetë prioritet që Qeveria e Kosovës, Nuk mund të jenë të gjitha prioritetet në Qeverinë e Kosovës, mund të jenë vetëm disa nga ato.

Çështje tjetër me rëndësi në këtë problem është se ne kemi kërkuar në një konferencë për arsim që me rastin e hartimit të Kushtetutës së re të Kosovës, arsimit të paraqitet si prioritet aty. Të përcaktohet me nenet e kushtetutës, nëse kjo punë s’bëhet, sistemi i arsimit do të vendnumëron sikur deri më tani. Prandaj ishin këto disa nga shqetësimet që unë i paraqita duke u lënë fjalën kolegëve të tjerë të cilët kanë çka flasin për gjitha këto probleme dhe unë ju falënderoj për kujdesin.

KRYETARI I KOMISIONIT ENVER HOXHAI – Ju faleminderit shumë z. kryetar, ju faleminderit shumë për këtë prezantim shumë detal shumë të gjendjes në arsim. Meqë pjesa më e madhe e jonë është edhe arsimtarë të niveleve të ndryshme e kuptojmë një gjendje të tillë, edhe pse fizikisht jemi të ulur, realisht jemi të ulur të dy pozitat edhe në atë anë edhe në këtë anë , kështu që realisht skica që ju ofroni për neve është mase e qartë. E dimë që bëhet fjalë për 27 mijë, ndoshta 30 mijë mësimdhënës që i ka Kosova dhe ky dëgjim publik është kyç në atë drejtim në përputhje me sugjerimin edhe të profesorit Nimon Alimusaj, ne si komision jemi në gjendje deri në orën 4 të gjithë juve çka jeni këtu të pranishëm t’ju dëgjojmë. E vetmja kërkesë e jona është që problemet të cilat i shtroni të jenë të natyrës sa më konkrete, sa ma faktike dhe sa më të prekshme, të cilat do t’ju mundësojnë gjithë deputetëve të këtij komisioni që vërtetë në një seancë të ardhshme plenare dhe përmes mekanizmave të tjerë, ta shtyjme këtë shqetësim që ju e keni, kështu që pas fjalës së kryetarit Shabanaj, unë ia kisha dhënë fjalën secilit prej jush, mirëpo meqë një pjesë e juaj ndoshta nuk njiheni në mes veti me deputetët ju kisha lutur secilit prej jush ta prezantoni vetveten dhe megjithatë prezantoni fushën e punës së juaj në kuadër të Sindikatës dhe për çfarë teme do të flitni.

X

Z. kryetar, zonja dhe zotërinj, miq të dashur deputetë . Shumë gjëra janë thënë në atë letër hapur këtu që ka dërguar SBASHKU institucioneve të Kosovës, qoftë edhe në debate të ndryshme them kështu, që janë zhvilluar në nivele të ndryshme, qoftë edhe nga parafolësit që i dhanë këtu. Ju në një kohë të mëhershme keni miratuar edhe një strategji të arsimit të lartë, të arsimit që ka periudhën 2005-2015 dhe shumë gjëra janë përfshirë në këtë strategji. Aty është konstatuar edhe gjendja po edhe nevoja për një transformim, nevoja për reformim dhe nevoja për zhvillim të arsimit të lartë. Unë po ndalem në këtë sferë këtu.

Sfidat janë të shumta. Ato unë kujtoj që për këtë nivel dhe për deputetë po them kështu janë të njohura. Rëndësia e arsimit përgjithësisht, ora e arsimit të lartë është e madhe, para se gjithash, ajo është një potencial i madh po them kështu dhe mundësi e madhe për një zhvillim të hovshëm të Kosovës, para së gjithash të një zhvillimi ekonomik. Kapitali njerëzor është një element bazë për rritjen ekonomike të qëndrueshme të shpejtë dhe se kjo lidhet tani edhe për një sigurim të një mirëqenie përgjithësisht në kuadër të Kosovës dhe në qoftë se gjitha ato merren parasysh edhe shumë elemente tjera të cilat po them janë në atë strategji, unë kujtoj që Kuvendi, por edhe Qeveria e Kosovës ka arsye, sepse një prioritet i tillë është shtruar edhe në kuadër të strategjisë që arsimin ta shtrojë si prioritetet të them kështu të shoqërisë kosovare. Kjo është kërkuar, e dini në kuadër të kësaj letre që i është adresuar institucioneve më të larta.

Problemet janë të shumta, të them kështu të gjitha niveleve të arsimit. Kjo ka të bëjë edhe me arsimin e lartë, si në fushën e politikës dhe të legjislacionit, në fushën e menaxhimit, koordinimit, në fushën e sigurisë së cilësisë, kërkit shënkencor të infrastrukturës, por unë kisha me dalë te ajo sferë që është e lidhur drejtpërdrejtë të themi për të cilën jemi të interesuar. Sigurisht që është bazë e gjitha këtyre tjerave është ajo e financimit dhe këtu hasim në disa probleme, them kështu, para se gjithash niveli i ulët i mbështetjes financiare për arsimin e lartë, megjithatë për kundër një rritjes që është bërë, të them kështu, ajo nuk është në atë masë që do të dëshironim, mos vlerësimi i duhur i arsimit dhe nënvlerësimi i shkencës, të them kështu, financimi i centralizuar i arsimit të lartë është, po ashtu, një prej problemeve që e tangon punën po them kështu me të madhe, pozita e vështirë materiale institucioneve të arsimit të lartë përgjegjësish e shumë të tjerë.

Gjithë kjo në një përshkrim atje që jepet në strategji është thënë se Kuvendi i Kosovës siguron konsensusin politik dhe shoqëror për përcaktimin e arsimit të lartë si një nga prioritetet e shoqërisë. Unë kujtoj që ju keni qenë ata që edhe keni miratuar këtë strategji edhe nëse është ashtu atëherë për të qenë nëse caktohet diçka si prioritet atëherë duhet të valorizohet ajo në masën që e përcaktojmë si prioritet.

Unë kujtoj se ka edhe vend në sferën e legjislacionit të them të arsimit të lartë edhe të statutit të universitetit të them kështu edhe ligjet tjera të themi që të bënë ndryshime të them dhe në formë të amendamentit të them të amendamentohen ato dhe të korrigjohen në këtë aspekt them të krijohen një legjislacion që do të ishte më i avancuar dhe do të krijonte hapësirë më të madhe për zhvillimin e arsimit të lartë.

Një prej momenteve të cilin unë kish ardhur me konkretisht është te përmirësimi i pozitës materiale të institucionit të arsimit të lartë. Diçka thash edhe më herët në këtë plan është realizuar para dy vitesh nëse ju kujtohet kur ishte greva së bashku, në këtë plan përfitojë më së shumti ju e dini universiteti, mirëpo edhe kjo nuk e ka zgjidhë problemin të them kështu të arsimit të lartë.

Pagat e punonjësve të universitetit janë më të vogla në krahasim me universitetet në regjion nëse i krahasojmë ato, të them kjo pozitë e vështirë, sidomos në pozitë të vështirë janë asistentët të them kështu të këtij universiteti që paraqesin vështirësi për të siguruar edhe një kuadër të ri edhe me perspektivë të universitetit, faktikisht pagat prej 250

eurosh, nuk janë joshëse për këtë kategori dhe ne ta dini që nuk kemi kuadër të ri dhe nuk janë të interesuar thjeshtë ai kudër të vijë në universitet.

Vetëm po e marrë një shembull që një asistent të themi me notë mesatare 10 që ka regjistruar nesër edhe doktoron mbanë titullin e asistentit në qoftë se nuk ka vend për profesor të them dhe ligjërues të tjerë ai e merr një pagë prej 250 eurosh dhe mendoni, po e marr shembull të fakulteteve inxhinieri, domethënë një inxhinier i makinerisë apo i elektron apo i ndërtimtarisë po sa del atje diku i merr mbi 500 euro diku shkon në KEK ose në Postë ose ndonjë institucion tjetër edhe starton me atë, dhe çka a është dikush i stimuluar që të vijë në universitet prej atij kuadri që do të ishte perspektiv të them nesër e zhvillimit, ne ta dinim pjesën më të madhe jo vetëm të asistentëve, por edhe të arsimtarëve nuk i kemi në Universitet , sepse ata janë të angazhuar diku tjetër, se atje është leverdia, dhe do të na mbete në shumtën e rasteve që atë ta zgjidhim në formë tjetër të themi ose si bashkëpunëtorë që nuk është ai niveli të themi edhe cilësia që do të duhej, prandaj po them këtë duhej ne ta mendojmë dhe mos mendojmë që e kemi zgjidhur të themi kështu normalisht kur e merr atë në raport me pagën e mësuesit të themi të arsimtarit normalisht që arsimtari universitar është i stimuluar, por po them ajo nuk është zgjidhje. Prandaj nëse mendojmë në këtë aspekt duhet të bëjmë diçka.

Miq të dashur kisha dashur edhe kështu, një çështje tjetër e cila është çështja e decentralizimit, qoftë në financa qoftë edhe në udhëheqje, kjo është një problem për universitetin. Unë nuk po hyj me elaboruar. Unë mendoj se gjithë e dinë si është situata, por po them kjo është një prej çështjeve të cilën duhet ta zgjidhim, sigurisht edhe me në aspektin me anë të ligjeve që duhet t'i miratojë ky Kuvend.

Ky decentralizim tani ka të bëjë edhe me sigurimin e një autonomie të plotë të them të universitetit dhe të njësive të tij, shpesh cenohet autonomia të them nga shumë subjekte të themi të cilët tentojmë ta kenë në dorë.

Tjetër, çështja e organizimit të mirëfilltë mbetja e një universiteti apo ndarja e tij me shumë sosh. Kjo duhet të diskutohet . Deri me tash është folur mjaft dhe është çështje që duhet të diskutohet. Unë kujtoj se kësaj çështje nuk duhet të hyjmë një minutë fushate, atë duhet, ndoshta, përmes një analize, një sfoto -analize që sot zakonisht bëhet në nivele të ndryshme, duhet ta analizojmë gjithanshëm. Kujtoj që aty duhet të kyçen të gjitha subjektet edhe ky Kuvend me kuadër që ka të themi, normalisht që Ministria duhet ta bëjë Ministria e Arsimit , Shkencës , Universiteti edhe shumë të tjerë të cilët them do të dilnin me një elaborat që do të ishte themi valorizim i mirë i asaj se çfarë Universiteti dëshirojmë. A dëshirojmë një universitet të tillë çfarë e kemi apo duam ta reformojmë atë përkatësisht të krijojmë më tepër universitete.

Depolitizimi i Universitet dhe i arsimit përgjithësisht, po ashtu, është një temë. Unë nuk dua me hy atje, është një temë të cilën duhet ta kemi parasysh, arsimin duhet ta ruajmë, si të tillë të themi të depolitizuar, arsimin duhet ta kryejë funksionin e vet, dhe të them këtë aspekt duhet të punojnë gjithë, unë kujtoj që ky është obligim edhe i juaji.

Në fund kisha tu falënderoj për durimin, në këtë dëgjim. Por kam edhe një kërkesë që angazhimi i juaj të mos shfrytëzohet vetëm si marketing politik në shumë rastet që mund të jetë, të mos mbetet vetëm në sferat e një debati teorik të them shpesh me dalë, ndoshta, sepse edhe po i dëgjojmë nganjëherë po them por të gjithë të angazhoheni dhe të jepni kontributin të them, sepse e dini punonjësit e arsimit atë e meritojnë dhe dinë ta vlerësojnë po them, por edhe ta shpërblejnë me punën dhe angazhimin e tyre të përditshme. Ju faleminderit.

X

Të marrim një përgjigje, domethënë Kuvendi le ta debatojë. Një çështje tjetër, po ashtu ,që është defekt e përmendi ma shumë, është çështja e arsimit parashkollor, në vend se të respektohet ligji pasi u nxjerrë ky ligj shumë i avancuar, shumë bashkëkohor, që këto paralele të rriten ne jemi dëshmitarë që këto paralele të shuhet. Unë konkretisht- Mbesa ime ka qenë e regjistruar në shtator në një paralele parashkollore, pas një muaji paralelja mbyllet me arsyetim të kuvendit komunal se nuk ka mjete.

Prindërit janë organizuar dhe kanë kërkuar nga Kuvendi që t'ju lejohet që ata të paguajnë vetëm mos të shuhet paralelja, merreni me mend as kjo nuk lejohet.

Jo, ne nuk guxojmë me lejuar këtë ne do të shikojmë do ti bëjmë mjetet edhe e rregullojmë, po e bëjmë një digresion, një mësues për një paralele paguan në muaj 160 deri 180 euro në muaj. Udhëheqësit tanë vetëm rojet që i kanë truprojat ka sa i kanë, por vetëm një truproje ma pak një paralele mundet me u financuar atje, ju faleminderit shumë.

KRYTARI I KOMISIONIT ENVER HOXHAI – Ju faleminderit z. Zeka,

X

Të nderuar përfaqësues të Grupit Parlamentar të Kuvendit të Kosovës. Unë jam profesor Qerim Selimi, kryetar i Sindikatës së Universitetit. Të gjitha këto që u thanë edhe nga kryetari i SBASHKUT edhe nga profesor Xhaferi edhe nga sekretari, janë vepra të cilat në mënyrë direkte dhe indirekte ndikojnë në Universitetin e Prishtinës. Universiteti i Prishtinës është i vetmi universitet publik për të cilin, varësisht nga interesat e juaja,d.m.th. të Kuvendit çohet pluhun edhe pozitiv edhe negativ. Ka menaxhim të dobët, o nuk i plotëson kërkesat e një universiteti bashkëkohor ose e kundërta, domethënë është një universitet publik i cili, varësisht nga interesat e politikës.

Unë në këto gjëra nuk do të hyj, do të hyj në do gjëra konkrete. Në bazë të ardhurave personale, Universiteti i Prishtinës qëndron diçka më mirë se sa krahasim me nivelet e tjera të arsimit, por nuk janë vetëm të ardhurat personale ato të cilat e përcaktojnë kualitetin e punës në Universitetin e Prishtinës, për arsye se dy nivelet e tjera brumi nga i cili vjen ,vjen i papërpunuar, si rezultat i mosgatishmërisë së këtij Kuvendi, i kësaj Qeverie në ngritjen e cilësisë dhe sasisë ,gjegjësisht në tri nivelet e tjera.

Faktikisht se një profesor i Universitetit të Prishtinës e ka një pagë diku 500 euro bruto plus një participim 250, që krahasohet me kolegët në regjion ndoshta është 100% ose 200 %, por krahasuar me një sekretar permanent në ministri të ministrive të juaja, e cila ke në mënyrë publike që nga 300 do të ngritët në 1200. A nuk është kjo nënçmuese për punëtorët e Universitetit? A nuk është kjo nënçmuese për një doktor shkence, kur një sekretar, ju pyes juve- Cilat duhet të jenë vetitë e atij sekretari? A duhet të jetë ai vetëm me fakultet apo me shkollë të mesme apo me ndonjë doktoraturë ekstra të cilët ju si Kuvend po i jepni këtë pozitë.

Një profesor i Universitetit të Prishtinës për të arritur këtë titull dihet shumë mirë. Universiteti i Prishtinës është i ri dhe gjitha kuadrat i ka aftësuar jashtë vendit, qoftë në Zagreb, qoftë në Beograd, qoftë në vendet perëndimore dhe këto quadro të kthehen dhe t'i kontribuojnë kësaj shoqërie është një çështje patriotike. Po nuk është çështje patriotike, është çështje kombëtare që këta të nënçmohen. Greva, e cila ishte vazhdimësi ose e asaj, në universitet e sjellin një nivelizim po ai nivelizim i pagave ka qenë një çështje politike dhe Universiteti duhet shiquar si tërësi e sistemit të arsimit në Kosovë. Universiteti diku ka 1500 punëtorë, ndër këta 1500, 1100 janë mësimdhënës, qofshin profesorë, qofshin asistentë.

Universiteti është në Prishtinë, ndërsa profesorët duhet të udhëtojnë nga qendrat tjera . Çështja e banimit është një problem esencial për punëtorët e Universitetit. Paramendoni se një profesor udhëton prej Prizrenit ose nga një lagje e Prizrenit, atij tanë koha i shkon rrugë, kur dihet se 5 ditë duhet të punon dhe të ardhurat personale, kurse ju, kam vendime cilat në Ministrinë e Ramushit njerëzve të cilët punojnë në Qeveri ose ju kanë dhënë shtesë 250€ ose ju ka siguruar banimi. Më vjen shumë keq që përballë jemi dy kategori, ndoshta d.m.th të njëjtit sistem dhe nuk ka pas nevojë që unë t'i përmendi këto për arsye se ju i dini shumë mirë, por është një çështje e kundërt në politikë derisa po vjen në pozitë, kur po vjen në pozitë po shikon vetëm nga një anë, d.m.th nga ana e interesit personal e jo nga ana e interesit të përgjithshëm. Për t'i arritur këta tituj, më falni që po e zgjati, secili prej profesorëve duhet së paku t'i ketë 3 punime shkencore për një avancim dhe këto punime shkencore duhet të arrihen me pjesëmarrje nëpër konferenca ndërkombëtare dhe këto pjesëmarrje nëpër konferenca ndërkombëtare kushtojnë materialisht. Ju lutem vetëm nga fakulteti i jonë janë refuzuar të gjitha kërkesat për pjesëmarrje në një kongres të biologëve me arsyetim se Universiteti s'ka mjete ose duhet dekani ose dikush tjetër të përcaktojë cili nga këta kandidatë ka prioritet dhe kjo kishte me qenë një kërkesë që në kuadër të Ministrisë të formohet një fond i cili i stimulon ose në një farë mënyre i avancojnë proceset shkencore, pjesëmarrjen nëpër konferenca.

E nderuara përfaqësuese e Ministrisë, uluni e shikoni librat në këtë rast ju i përfaqësoni të gjithë ata. Shikoni d.m.th, tekstet shkollore shkruhen nga grup njerëzish që unë njihem me Enverin, Enveri mi jep sepse më ka shok pa marrë parasysh a më takojnë apo jo. Janë ngjarje të cilat reflektojnë dhe njerëzve disave ju jepen favore, disave nuk u jepen fare.

Në kuadër të Universitetit të Prishtinës. Universiteti siç thashë në fillimi është i ri dhe është gjenerata e parë që del në pension. A kemi ne aq shumë kapacitete njerëzore që të gjithë këta njerëz t'i përjashtojmë nga Universiteti, t'i qesim në rrugë me 40€? Kjo ka mundësi që në kuadër të Qeverisë, në kuadër të Kuvendit të nxirret ndonjë mekanizëm që këtyre njerëzve, jo për çështje materiale, por për nevoja të Universitetit t'ju sigurohen kabinetet, t'ju sigurohet pagesa se mjafton një profesor, jo të mban mësim, por të jap konsultime profesorëve dhe asistentëve të ri. Pas zgjedhjeve në Universitet gjërat kanë filluar disi të rrjedhin si normal, ka mjaft vërejtje, por si normalisht, duke u respektuar statuti dhe duke u respektuar rregulloret .Shpresojmë që edhe ky dëgjim publik do të jetë si shkak që në njëfarë mënyre edhe Universiteti edhe të gjitha nivelet tjera të shikohen me një sy kritik e jo me një sy përkëdhelës dhe kërkojnë pagat t'ua rriten pagat, por cilat janë mundësitë që si Kuvend të ndërmerren që të rritet kapaciteti njerëzor në të gjitha nivelet, po duke e çmuar punën. Ne nuk kërkojmë lëmshë. Ju kujtohet greva dhe në fund erdhëm në dakord për hir të asaj të një procesi, përndryshe kjo ka pasur mundësi të fillohet ose të mos fillohet dhe dëgjimet e tilla, transparenca në mes sindikatës, Kuvendit dhe Ministrisë janë çështje shumë me rëndësi se ne kur i kemi informatat e sakta sa është buxheti, sa janë mundësitë ,sigurisht që edhe ne në kuadër të atyre mundësive do të bëjmë llogari, Jo të thuhet se janë 7 milion e gjysmë për arsim, në fund del 1 milion ose as ai milion nuk ekziston, d.m.th raporti i sjelljes së juaj ndaj sindikatës, ndaj arsimit në përgjithësi është shumë me rëndësi dhe shpresoj që në të ardhmen kjo do të reflektohet. Ju faleminderit për vëmendje.

ENVER HOXHA – Ju faleminderit shumë profesor Selimi.

Jam RRAHMAN JASHARAJ – kryetar i Sindikatave të Arsimit Fillor të Kosovës . Do t'i iki përsëritjeve të gjëra që i thanë kolegët e nderuar nga SBASHK-u, por do të isha ndalur në çështjet që vërtet nuk po thuhen publikisht, por pasojat po shihen te ata që janë më të pafajshmit, te nxënësit.

Shpeshherë në media njerëzit e pushtetit, që nga viti 1999 deklarohen sa për t'ua bërë qefin njerëzve se gjendja është e mjeruar në arsimin fillor, të mesëm dhe universitar.]Unë do të thosha se kohëve të fundit ka filluar të kthehet nga e mjeruara në gjendje tragjike. Pse në gjendje tragjike? Ngase mësimdhënësit të përballur me mijëra probleme e nga ana tjetër, po ashtu, edhe nxënësit të përballur me problemet e tyre ka bërë që shkolla fillore edhe e mesme të mos jetë më vend ku nxënësi shkon me kënaqësi, por të jetë një vend nga nxënësi ikë me kënaqësi. Nëse i marrim statistikën në drejtorate për arsim dhe në shkolla fillore dhe të mesme kudo në Kosovë është alarmante dhe vetë njerëzit që punojnë në arsim e kanë alarmuar se kemi ikje masive nga orët e mësimi. Fëmijët,duke mos parë asgjë interesante në shkollat tona ikin dhe shkojnë gjëtk. Pse ndodh kjo, sepse nga vitet e pasluftës qeveritë cilado qoftë ajo mburren me donacionet që i ka dhënë dikush tjetër dhe kanë ndërtuar ndërtesa shkollore, por shkolla shqipe e Kosovës i gjasen një shkollë që nga Greqia antike, shkumësi dhe shpuza. Po ju marr një krahasim shumë të saktë, pasi që punoj në Shkollën Filllore 8 Marsi ku isha edhe nxënësi në Pejë, pra,para 35 vjetëve kur kam qenë nxënësi i kësaj shkolle fëmijët kanë pasur kabinete. Pas 35 vjet ku unë jam mësimdhënës tash asnjë kabinet nuk është në një

shkollë që vërtet ka emër të mirë në qytetin tim të Pejës dhe çfarë bëri Qeveria? Nuk bëri asgjë, problem që u shtrua, por nuk u tha troç? Kolegë të nderuar dhe ju deputetë të nderuar ju lus ta ngrisni zërin ,sepse ne nuk po e hetojmë një rrezik brenda shkollave, mësuesi po e fsheh sëmundjen, sëmundja mund të jetë ngjitëse dhe pastaj do të kemi pasoja te fëmijët. Për ta mbrojtur bukën e tij mësuesi po paraqitet i shëndoshë dhe nuk është i tillë. Më mirë është të sigurohen mbulesa për mësimdhënës të tillë se shqyr nuk janë me mija se sa t'ua krijojnë kushtet aq tragjike e ai ta fsheh sëmundjen. E ndiej veten edhe tani keq kur mësimdhënësi im i kimisë nga Peja që kishte infarkt mezi ecte shkallëve dhe binte në sy të nxënësve dhe ne ashtu në mënyrë aktorese e kishe jemi shokë e kapnim nga krahu për të shkuar deri te klasa e tij, për të arritur moshën për ta marrur pensionin 40€.Edhe kjo është një tragjikë tjetër për arsimin shqip . Ejani po e bëjmë një xhirim, mësimdhënësit tonë blejnë tesha në lamë që i themi ne në Pejë dhe me ato tesha dalin para fëmijëve dhe në këtë mënyrë është degraduar titulli i mësuesit. Dikur e mbajmë mend të gjithë ne kemi menduar se mësuesja ime apo mësuesja juaj nuk han bukë se ka ardhur nga qielli dhe fjala e saj ka qenë dominuese. Tani përballemi me një shkollë që vërtet nuk i takon shekullit që jemi dhe bëhen alamet projekte, bëhen alamet fjalë, tekste. Kur i dëgjon njeriu thotë ishalla, mirëpo na besoni neve të Sindikatës, jemi në presion shumë të madh nga kolegët, madje pas çdo greve ne për një muaj e bajmë titullin tradhtar, sepse kemi lëshuar pe dhe nuk kemi lëshuar pe, por Ministria e Arsimit nënshkruan diçka para kamerave e të nesërmit qesh me ne dhe asgjë nuk vëhet në jetë.

Do t'ju kisha lutur të keni konsideratë kur do të mbahet ndonjë takim në Parlament t'ju thuani troç organeve qeveritare se reforma që u propagandu e u fol për te me fjalë aq të mëdha i gjason , siç thotë populli” kur njeriu e kap gjarprin për bishti dhe dihet se gjarpri ka me e kafshu atë që e kap për bishti”. Pse po them kështu? A ka gja ma tragjike kur kërcënohen mësimdhënësit - thonë se në vitin e ardhshëm shkollor në klasat e pesta do të sillen mësues nga jashtë për t'i marrë klasat e pesta, më falni, mësuesi do të kthehet në klasë të parë dhe drejtorat kërcënojnë mësimdhënësit duke ju thanë shikoni 6 klasë të pesta minues 5 orë 30 orë shqip po humbin, një mësues e gjysmë mbetet jashtë dhe tash këtë e bëjnë që mësues të jetë ai servili që t'i thotë mirëdita si jeni etj, etj dhe tmerret e mëkatet që bëhen nëpër shkollat tona. Paramendoni kur në shkollat tona shpesh më shumë ka mirëkuptim dhe punohet çdo gjë me mirëkuptim se sa që ka ligje me të cilin drejtori do të punonte detyrën e tij, ndërsa mësimdhënësi do të kishte mbulesë. Do t'ju kërkoja ndihmë edhe në Parlament që kur është fjala te gjuha standarde duket çështje shumë e imtë, por nuk është. Kemi këtu profesorë të nderuar dhe nuk po e them këtë për të treguar se e di edhe unë. Që nga viti 1972 thuhet se e kemi gjuhën standarde. Ejani nëpër shkolla do të tmerroheshi çfarë gjuhe flitet. Për këtë edhe” kontributin” më të madh po na bëjnë mediat elektronike të Kosovës ku lejohet që të flitet një gjuhë thjeshtë e qarshisë. Më mirë flitet shqipja në qarshinë e gjatë në Pejë se në disa emisione të kontaktit që fatkeqësisht janë shumë të popullarizuara në mes të rinjve, Dhe përfundimisht kolegët e mi nuk e përmendën shumë- kuptojeni si shumë serioze deklarin tonë se do të ketë grevë. Mos e kuptoni se ne do të bëjmë grevë që po na shihni para jush, por besoni çdo ditë që dal në Pejë për me ble qoftë një gazetë,qoftë një diçka më rrethojnë mësimdhënësit dhe thonë çka po

bëhet dhe të gjithë janë për grevë dhe ju lus, ju kemi dhënë votën tonë mos na qitni në pozita që sindikata jonë, kolegët tanë, mësindhënëti tonë të na konsiderojnë si tradhtarë, sepse nëse e humbim lidhjen me bazën, ne do ta keni si institucione shumë më vështirë. Më lehtë është të bisedohet me magjistrin Ali Shabanaj dhe me njerëzit që kanë ende votën dhe besimin e mësuesve se sa të shpartallohemi, sepse vitin e kaluar, më falni që po e them edhe këto fjali dhe po e përmbylli. s'mundem pa e thënë - në grevën e tetorit institucionet qeveritare alamet energjie kanë harxhu që neve të na shkelin, që të na përgojnë që të na thejnë, që të na paraqesin edhe armiqë të përbetuar të institucioneve dhe alamet gabimi ka qenë kur Ministria e Arsimit themelon një këshill të prindërve brenda Ministrisë, të cilin fatkeqësisht e ktheu në vegël për veti dhe paramendoni kur prindi ngrihej publikisht kundër mësuesit, kush është mësuesi nesër pas grevës kur hyri në klasë, d.m.th. na" bëri "po them fjalë më të lehta Ministria në vend që të na gjej një mik, neve na bëri një armik me këshillin e prindërve.

Sindikatat e SBASHK-ut e keni mik, arsimin e keni mik, por ju lus ta ngritni këtë çështje tek institucionet tona, le të na konsiderojnë si miq, ne jemi mësuesit e fëmijëve tuaj. Faleminderit. Profesor. Urdhëroni.

Unë jam BISLIM BEHRAMI- koordinator për rajonin e Prishtinës nga SBASHK-u. Punoj në Obiliq në një shkollë fillore. Me qenë se rajoni i Prishtinës përfshin edhe 5 komuna të tjera problemet e Prishtinës dhe të Kosovës në arsim janë të njëjta. Ndoshta bisedat që i bëjmë ne mund t'i ngjajnë monologu, sepse të gjitha këto janë të njohura për ju, sepse asgjë mos paqit njohuri nxënësin e keni në shtëpi që vjen prej shkolle në shtëpi dhe si niset prej shtëpie. Mua sot më kënaq fakti - vetë titulli i takimit quhet dëgjim dhe virtyti më i madh i njeriut është që të mund të dëgjohemi. Është hera e parë që na dëgjohemi në këtë formë dhe në këtë mënyrë prej juve, të cilët ju jeni ne e na jemi ju. Nesër ne mund të jeni atë anë e ju mund të jeni ne këtë anë, prandaj brengat dhe dhembjet i kemi të përbashkëta. Të gjitha ato çka do t'i themi do të mundohemi t'i zgjidhim bashkarisht, është një interes e ai është arsimit, nxënësi, ardhmëria jonë. E dini se japonezët kanë thënë: "Nëse mbarojmë një fabrikë kemi investim 10 vjet, nëse investojmë në arsim kemi investim të përjetshëm". Në një intervistë televizive ka qenë rasti, isha në një blic dhe na thanë: "Paret i hëngri KEK-u". thash paj normalisht se për ne arsimtarët ma vlerë ka drita e mendjes dhe diturisë se sa edhe kjo dritë këtu, d.m.th mendja e diturisë e jo drita e KEK-ut, Kemi jetuar edhe me llama, s'ka qenë mirë, por gjallë jemi mbet. Të gjitha këto rrjedhin prej arsimit, kush është arsimit dhe kush është arsimtari. Së pari kisha pasur dëshirë që u përmend edhe nga kryetari që struktura ligjore nuk përkon me realitetin e arsimit Kosovarë. Ligjet që i kemi ne janë ligje të kopjuara nga jashtë, janë ligje të niveleve dhe standardeve evropiane, të cilat asnjë milimetër nuk përputhet me mundësitë që ato të zbatohen si ligje. P.sh. është një nen atje- thotë se të gjithë nxënësit e shkollës fillore tekstet i kanë falas, në ligj e kanë shkruar, Asnjëherë nuk i kanë marrë, bile, ato tekste nuk po na dalin as me kohë, tekstet na dalin diku në dhjetor, janar ose shkurt që arsimtari vërtet është i indinjuar dhe është i hendikepuar, sepse tekstet e reja janë tekste të reja të cilat janë të punuara për reforma shkollore, siç tha edhe z. Aliu përfundon në vitin e ardhshëm me klasën e pestë. Neve na thuhet se ju duhet të pritni deri sa të vjen

libri i ri. I mbajmë disa seminare verës Rabiti e din, vijnë një ditë aty dhe dy ditë, një ditë brenda një ditë e mbajmë një seminar, vijnë 3 vetë flasin e hamë ka një pleskavicë dhe nga dy shishe ujë të tharbtë i pimë dhe kthehemi prej shtëpisë, u krye seminari, Nuk u krye seminari, reforma që neve na prek më së shumti, reforma as që ka filluar në aspektin përmbajtësor e tha edhe Aliu. Kush është mësuesi? Mësuesi është ai që e dini edhe ju 150€, 40€ udhëtim, 20€ nga një kiflet bëjnë 60€ edhe 100€ paguan banesën janë 160€ ka aso raste edhe ai duhet me mbet, ma nuk di çka bahet me arsimtarin. Me kontratë kolektive i kemi mashtruar arsimtarët do ta kemi ushqimin, do ta kemi udhëtimin bile 30% ose 50% me bë një digresion nuk e di a ka vend, para lufte besoni me 150 marka jemi pajisur dy herë më mirë se sot me 150€. Para lufte gruaja ka pasur 1 vit pushim e lindje. Para lufte arsimtari pushim mjekësor e ka pasur 100% në raste specifike, lëndim në punë, sëmundje profesionale etj. Asnjë këto 7 vjet mas lufte me ligjet më të reja, ne kemi menduar se do të jem edhe më të avancuar me diçka, sot arsimtari nuk i ka këto. Mirë tha Rrahmani, na nuk guxojmë as me u smu, në shportë e keni pa as me u martu. Ne nuk guxojmë as me vdes. Nuk kemi pare as për martesë e as për vdekje, nuk po e them këtë për t'ju shti në gjynah, por po e them se është realitet. Shkolla është pa ujë, nëse e shihni një shtëpi pa rrethoja apo me rrethoja të rrëzuara dhe me mure të pa bojatisura dini se është shkollë, mos pyetni ma tepër për të. Për kabinete u fol. Pastërtia e sidomos në fshatra atje nxënësit udhëtojnë dhe nga 2 kubik lloq i bien brenda në klasë dhe prej atyre pastruesve që i kemi pasur 10 pastrues na i kanë larguar komunat dhe i kanë lënë 2, njëri i bjen ziles, kurse tjetri thotë se për 130 € ndaqit po rri ndaqit po shkoj, faktikisht ne nuk mund ta mbajmë as pastërtinë në shkollë, aty janë nxemjet klasike me dru, duhet me bajt qymyr edhe ato mungojnë deri në dhjetorë nuk na vijnë drut.

Pranimi i punëtorëve legjislacioni e parasheh, ne nuk e dimë kurrë se kush kur na vjen në shkollë dhe merreni me mend tash e kemi zbuluar se në shkolla tona kanë punuar nga 5-6 njerëz të cilët kanë qenë falsifikator me diploma false dhe na vjen ai zotëriu, e njeh dikush në komunë, kur tash mbas 4-5 vitesh na i zbuluar, njëri ishte profesor i biologjisë, njëra ishte arsimtare e matematikës dhe ato pse, sepse ne nuk jemi ata që i njohim. Po t'i pranonim ne arsimtarët që i njohim na e dimë bile që e ka kryer shkollën. E dimë ku ka punue, e dimë çfarë sjelljesh ka pasur, Në të njëjtin stil është zgjedhja e drejtorit. Ju lutem drejtorët nuk kanë kurrfarë pune përveç dëgjimeve politike në shkollë.

Decentralizimi në shkolla, kur jemi takuar për herë të parë me Dagsnerin i patëm thënë se ky stil që je përgjegjës është centralizim i sistemit në shkollë, jo tha me juve duhet 17 vjet me prit me i kuptua këto gjëra. Unë e di se neve na mungon shkumësi. Besoni që duhet me prit një muaj ditë deri sa të na bie dikush shkumësin. Nuk kemi poça elektrike, duhet me ba një kërkesë e me shku në komun, ai i komunës te prokuratori është i Kenisë, u shku në pushim, ai tjetri është i Rusisë deri sa të vjen me nënshkrua besoni poça elektrike nuk kemi. A thua nuk jemi na ata njerëz që i kemi mbajtur shkollat dhe e kemi pasur buxhetin tonë, bile në lëmi të thjeshta, bile shpenzimet elementare të shkollës, shkumësin, me pagu rrymën, me pagu ujin, me ngjit një derë, thotë nëse t'u ka prish kufi e derës bën një kërkesë e vjen një firmë e për atë firmë duhet me ba një kërkesë. Ne u mërdhim burra dera qel deri sa të vjen ai, ta gjejnë një, jo ky ma lirë, ky ma shtrejt a thua dikush që po

han nga këto çështje atje me këto tendere, le të mbetet shpirti në natyrë pra se edhe ne po e dimë se edhe ato po keqpërdoren, këto janë krejt që ne i kemi në kurriz. Ishte fjala te arsimi parashkollor. Arsimi parashkollor jo që është i preferueshëm, por është i domosdoshëm edhe nga një element tjetër ai varet. Me ligjin e ri të arsimit nxënësi shkon 6 vjet në shkollë, po ajo absolutikisht kushtëzohet që nxënësi që shkon 6 vjet duhet të ketë qenë në mësim parashkollor. Te na nxënësi vjen 6 vjeç ose pesë e gjysmë se ju ka mërzit atje të shpia 4-5 gra dhe haj t' u ha dreqi shkoni në shkollë na bjen aty me ligj është që nëse deri në fund të vitit i banë 6 vjet nuk ke qare pa e marrë, faktikisht në mësim parashkollor nuk ka qenë. Ajo është dështim për familjen, por familjen tonë dikush e kupton e dikush nuk e kupton. Arsimi parashkollor është një parapërgatitje shumë e domosdoshme, sepse niveli i ofrimit të njohurive dhe mundësitë materiale që jepen nxënësit 6 vjeçar nuk ekziston në shkollat tona, ne nuk kemi projektor, nuk kemi televizione, nuk kemi emisione televizive me të cilat mund të punohet me atë nivel të nxënësit 6 vjeç, kjo është një katastrofë.

Unë ku punoj dhe në regjion të Prishtinës është edhe një problem, të gjithë kanë grumbulluar në Prishtinë, kurse terrenet kanë mbetur të thata. Në Prishtinë janë 0.03m² ku punon zotëriu e shumë e shumë tjera. Ne arsimtarët nuk jemi të dënuar vetëm nga pagat, nuk jemi të dënuar nga statusi, por jemi të dënuar burrë edhe nga puna edhe ndoj ditë ne nuk do të kemi as oksigjen në shkolla për të thithur. Ju kisha lutur të gjitha këto janë elemente të cilat e përcjellin seriozitetin tonë, seriozitetin e juaj dhe zhvillimin e ardhshëm. Pastaj, siç thashë këto janë bërë hiperproduksion nxënësit, kurse marrim shembull Obiliqin në tri shkolla kanë mbetur nxënësia pak. Elektroekonomia ju thotë dilni prej këtu udha e mbarë u koftë[- shkoni kah të doni. Ne punojmë plus me klasë të kombinuara. Merreni me mend nëse një mësues punon me klasë të kombinuara, 30 minuta është ora, nëse ti ja kontrollon detyrat njërës klasë, klasa tjetër mbet. Çfarë arsimi ose mësimi është ai me klasë të kombinuara. Ju lutemi të bëjmë atë çka bëhet, t'i bëjmë disa restriksione dika, ti bëjmë disa restriksione edhe në Qeveri. Arsimtari ja ka lakmi pastruesit në PTK, arsimtari ja ka lakmi kuririt të Aeroportit, arsimtari ka ikur prej shkollës dhe është bërë përkthyes në UNMIK, është bërë pastrues, arsimtari është edhe moler edhe taksi edhe bartës i mallrave, prandaj arsimtari është duke e bartë barrën e madhe mbi kurrizin e vet. E kam një arsimtar, meqenëse thatë do elemente kështu, e ka emrin Adem besoni që paguan 100€ qira në Prishtinë, udhëton në një fshat Lajthishte e Obiliqit, 2,60€ i kushton rruga andej e këndeje edhe e ka një grua të sëmurë të cilën çdo 2 muaj e çon në Lubjanë për shërim, sepse atje e ka operuar. Tash do të del në pension dhe erdh një ditë në shkollë dhe tha se çka do të bëj besoni se kjo është gjendje reale dhe tha se ku do të shkoj unë, ne nuk kemi çka ti bëjmë se ligji thotë 65 vjet dhe rruga e mbarë, ndash vdis ndaq si të duash, ai është i Vuthajve dhe punon 45 vjet këtu. Një fat i tillë mund të jem unë, ti, ai dhe të gjithë ne, prandaj vërtet duhet të mendojmë pak më në detaje për arsimtarin. Çka ishte bërë sikur t'i kishim hequr nga buxheti i Kosovës nga 3 cent për kafe, 3 cent për cigare, 3 cent për parfumeri dhe kozmetikë, 2-3 cent nga lojërat e fatit dhe një tatim nga qiraja që nuk e paguan askush kurrë në Kosovë, a i marin nga 7-8 euro qira, a nuk do të ishte kjo një ndihmë për arsimtarin, bile bukën, rrugën, bile ka mundësi edhe një kabinet apo çkado të vogël në shkollë me mujt me pru. Shkolla është e madhe, shkolla ka

shumë kërkesa, ne jemi ata që po mundohemi të harrnohemi disi, por besoni ju burra dhe ju të nderuara motra edhe durimi deri diku po shkojke. Unë punoj qe 35-6 vjet, kolege e kam Salen, kjo ka qen 1 vit ma e re, e kështu duket shumë më e re se unë se erdh në qytet e ka pak ma mirë. Vërtet arsimit është i degraduar në të gjitha nivelet, edhe arsimit fillor, edhe parashkollor edhe universitar. Valla qysh tha njani djemëve as nuse s'don me u dhanë. Çka je mesues, hajt hiçmu ti Na falni, ndoshta ju shurdhumë .Ju faleminderit që patet durim me me dëgju.

ENVER HOXHA – Të faleminderit shumë profesor Behrami.

BESNIK KRASNIQI – Kryetar sindikal i arsimit të mesëm të Kosovës. Ju falënderoj që keni bërë të mundur këtë dëgjim publik, mirëpo do të isha shumë falenderues sikur këto halle dhe kërkesa tona t'i bashkëjetoni, t'i merrni tepër seriozisht ,t'i dërgoni atje ku e kanë vendin në institucionet e Kosovës dhe të ngulni këmbë për realizimin e pjesës dërmuese të këtyre. Të mos na ndodh që mandatin e deputetit 3 apo 4 vjeçar ta përfundojmë pa e thënë asnjë fjalë, a në të njëjtën kohë pagën e majme të deputetit ta marrim pa hezitim. Unë nuk do të ndalem në shumë detaje që i dhanë kolegët e mi, por do të ndalem në disa të tjera që janë të përafërta me këto: Te numri i madh i nxënësve se unë vijë nga një regjion, vijë nga Prizreni ku për standarde të plotësuar mund të jetë shembull për gjithë Kosovën, sepse nuk ka shkollë fillore ose të mesme në Prizren që nuk mëson në të tri gjuhët, d.m.th në gjuhë shqipe, boshnjake dhe gjuhë turke, madje kemi edhe shkolla që punojnë siç është rasti në Lumbardh vetëm në gjuhën boshnjake, pastaj edhe në Sharr dhe shkolla e Mamushës që punon vetëm në gjuhën turke dhe ne krenohemi me këtë sepse u kemi dhënë mundësi që edhe minoritetet të kenë të drejtën e shkollimit ashtu siç i ka pjesa shumicë, kemi vuajtur nga diskriminimi e ish pushtetit, nuk duam që tash e tutje të njëjtat diskriminime t'i përjetojnë njerëzit që jetojnë me ne, me gjithë atë, këtu sikur po bëhet një diskriminim pozitiv në kuadër të minoriteteve. Do të marrë një shembull në shumë shkolla fillore dhe të mesme të Prizrenit punohet në tri ndërrime, në shumë shkolla fillore të Prizrenit kemi edhe 45 nxënës, ndërsa në shkollat e minoriteteve çofshin ato boshnjake ose turke ka nga 4-5 nxënës dhe paguhet arsimtari nga buxheti i Kosovës. Kur shkolla nga shkolla mund t'i ketë përafërsisht një kilometër gjë që do të mund të lëviznin sepse kjo shkon në dëm të arsimtarëve shqiptarë, ju lutem atje kemi paralele me 4-5 nxënës, ndërsa këtu duhet t'i bëjmë 45 e më tepër.

Sa i përket kësaj unë kisha një kërkesë për Ministrinë e Arsimit që t'i shqyrtojë këto probleme se janë në të mirën e punëtorëve të arsimit shqiptar në përgjithësi. Nën dy, janë ndalesat e pagave që po na ndodhin herë pas here muajve, me 7 me 8 me 15 e çka di unë, shumica e arsimtarëve të Kosovës janë futur nëpër kredi të ndryshme për të jetuar, për të ndërtuar diçka, etj dhe po ndodh që nga bankat pas dt. 7 t'ju ndalet kamata, disa nga kërkesat e tyre i kemi prur edhe në SBASHK-ë, por i kemi edhe në nivel të Prizrenit, prandaj kjo edhe më tepër po e rëndon pozicionin e arsimtarëve. Kur jemi tek tekstet shkollore në vitin e kaluar Ministria e Arsimit ka organizuar një seminar njëditor kam marrë pjesë edhe unë me arsimtarët që punojnë me paralele boshnjake dhe paralelet turke dhe i kemi shtruar ca kërkesa, asgjë as me shkrim dhe as me gojë nuk na ka ardhur. Kërkesa kryesore ka qen që të

punohet më tepër tek përpilimi i teksteve, dihet mirëfilli se asnjë klasë nga klasa e katërt e deri në 10, 11, 12 aty ku ka edhe 13 asnjë libër për gjuhën shqipe nuk është botuar deri më tani dhe ne gjendemi ashtu siç mundemi dhe që është edhe më kryesore, por as edhe në gjuhën e atyre minoriteteve.

Për shembull shumica e arsimtarëve në gjuhën boshnjake, por edhe në gjuhën turke pajisen me tekste nga Bosna, nga Serbia madje, madje edhe nga Turqia, kjo po ngjanë sikur vetvetiu në mungesë të krijimit të teksteve po i anashkalojmë, sepse ata veç deklarohen se punojnë në kuadër të sistemit arsimor të Kosovës, por në fakt ata punojnë me tekste të tjera. Të deklaruar se punojnë me plan program të Serbisë, dihet mirëfilli. E kemi pjesën Gorës atje, disa nga fshatrat, por të tjerët janë deklaruar se punojnë me plan programet tona dhe duhet t'ju krijohet mundësi që dhe ata të jenë pjesë e kësaj shoqërie, dhe ne e kemi për detyrë, qoftë Ministria e Arsimit, qoftë organet tjera gjegjëse që merren me këtë punë ta kenë prioritet këtë problematikë.

Unë nuk do ta zgjasë më shumë, besoj se kanë edhe të tjerët diçka çka të thënë, të mos i përsërisim gjërat. Ju faleminderit!

KRYETARI ENVER HOXHAI -Po profesor,

XXX

Në Obiliq, në komuna ku janë të përziera janë shumë interesante. Për shembull tek ne merret numri i nxënësve edhe i serbeve dhe i shqiptarëve, kur pjesëtohet me numrin e arsimtarëve, ajo mesatarja është 20 e sa është atje me ligj, faktikisht ne duhet me i qua 10-15 arsimtarë shqiptarë te shpija, me ua plotësuar kriteret e arsimtarëve serbë që kanë ka 3 nxënës, sepse ai po hynë në përqindje, ajo duhet me u shqyrtuar në vend të ngjarjes siç thonë se serbët në klasën, në shkollën time punojnë 13 nxënës serb edhe 17 arsimtarë, llogariteni tani, ajo vjen në përqindje me u nda për kokë të arsimtarit na dëmtohem me buxhet edhe vijmë e na thonë: qitni 5 arsimtarë, bëni çka të doni, i keni pesë arsimtarë më tepër, është për shembull Mitrovica, është Kamenica, Obiliqi, Lipjani e shumë shkolla, Gjilani ku Ragipi i di shumë më mirë se unë edhe dy tri here e kemi cekur këtë moment, edhe një here po na krijojnë probleme.

Na nuk mundemi me i qitur arsimtarët tonë edhe nuk mundemi na tash përqindja, po duhet me i plotësuar na me nxënësit tonë arsimtarët serb, tre nxënës unë po duhet me ia bërë 20 për me mbetur ai në punë. Më falni ky ishte ai elementi pak më i ndjeshëm është edhe mund të shkaktoj tash probleme. Ju faleminderit!

KRYETARI ENVER HOXHAI – Ju faleminderit profesor Krasniqi. Urdhëroni

Unë nuk do të zgjasë shumë, ju faleminderit z. Kryetar, por do të lexoj diçka që në njërin anë shkruan letër, në vendim ku merr secili punëtorë për një vjet, ndërsa kjo bie në kundërshtim menjëherë me vetveten. U përmend sigurimi shëndetësor dhe pushimet mjekësore. Punëtori ka të drejtë në 15 ditë pushim me pagesë, ndërsa një vendim të cilin e nënshkruajmë na të gjithë që është bllanko shohim. Pushimi mjekësor për shkak të aksidenteve profesionale, po e lexoj kështu që unë nuk i

kuptoj aksidentet profesionale kisha pasur dëshirë me ma shpjeguar, apo sëmundjeve profesionale mund t'u lejohet me pagesë të plotë për një periudhë tremujore, jo jo e kanë parë këtë kush e di prej çkafit është kopjuar – periudhë tremujore dhe me gjysmë page për periudhën e ardhshme tremujore me rekomandimin e mjekut, nuk po e lexoj më poshtë. Ky është një vendim i lëshuar në Kuvendin Komunal të Prishtinës – Departamenti – Drejtoratit Komunal i Arsimit të Prishtinës, të cilën e marrin të gjithë mësuesit, e nënshkruajnë këtë dhe kjo kur vjen në praktikë nuk zbathet sepse i ke 15 ditë ato që të takojnë – shko aty edhe më tjera pushime pa pagesë nuk ka.

U cekë rasti që e humbë vendin e punës. Prandaj, është mirë që qoftë Qeveria, qoftë Parlamenti, qoftë drejtoritë komunale, vendimet të cilat i marrin ose që i lëshojnë që ia dhënë punëtorit të paktën këto me shkrim, me iu përmbajtur atyre, ke pushim tre muaj ditë për sëmundje ose aksident që ndodhë, që shumë punëtorë bëjnë aksidente në rrugë e duke ardhur në vend të punës ose të sëmurë, ato që i përmendëm këtu, unë i kam në shkollën time mësuesit edhe mësueset që sot vijnë, mu më vjen shumë keq kur e shohë në fytyrë, që nxënësit ka paralajmërim me i tërhequr fëmijën se mësuesja është në aso gjendje dhe mësuesja duhet me ardhur qasi soji në shkollë.

Kjo është një tmerr, nuk po flas për gjendjen të cilën ju veç, edhe ju si parlamentar e dini, sepse vini nga sfera e arsimit, i keni tuat që punojnë në gjithë ato, por ky është një diçka. Edhe një shqetësim që mua, e dëgjova mbrëmë, tha: Seanca e Parlamentit të Kosovës që ka pasur të bëjë fjalë për arsimin fillor tha nuk do të mbahet, kështu ka qenë mire bashkërisht, sigurisht ndonjë konkluzion ose çka do të nxirret, është mirë që ajo të mos jetë me u kënaqur me u kënaqur të gjithë ne sepse është bërë një dëgjim publik, u morëm vesh, biseduam, i dëgjuam hallet e njëri tjetër se unë them thjeshtë e kuptoj dhe konsideroj që të gjithë ju këtu çka jeni e keni shqetësimin dhe e keni treguar gatishmërinë me ardhur me bashkëbiseduar për këtë, por kjo të shkon më lartë.

Të mbahet ajo seancë, në qoftë se nuk mundet, ne e kuptojmë gjendjen e rëndë e cila është në Kosovë tash, tash është problemi i statusit, janë ato që vijnë ndërkombëtarët, Grupi Fatkt Mbledhës e krejt, por të paktën në qoftë se nuk mundet me u mbajt të premtën, të paktën të mbahet menjëherë, në mënyrë që edhe neve si mësime dhënë mos të mbesim se kërkesat tona ose letra e hapur që është nënshkruar së bashku. Nuk ka qenë letër e krijuar prej Kryesisë së bashku, por ka qenë letër që ka ardhur prej të gjitha rrethëve të Kosovës, prandaj na është dashur me e bërë me e qitur në letër dhe me e dërguar. Mos të del ndonjë problem aty, në mënyrë që nesër, pasnesër me na ardhur një diçka e pakëndshme që nuk është as për neve as për krejt Kryesinë dhe për të gjithë njerëzit që vijnë, por është një shtrëngim prej terrenit. Ju faleminderit!

KRYETARI ENVER HOXHAI - Ju faleminderit Profesor! Urdhëroni

NEZIR GASHI – I nderuari Kryetar, të nderuar deputetë E pata fatin më duket këtu i fundit të jem. Vijë nga komuna e Prishtinës, kryetar i sindikatave të Komunës së Prishtinës. Për mos me e zgjatur, meqë u cekën shumica prej tyre. Meqë të gjitha këto probleme që u cekën, unë mendoj të gjitha këto i ka në barë Komuna e Prishtinës dhe nuk ka nevojë të hyjmë në detale kështu, por unë do të ndalem në tri çështje të cilat na preokupojnë si sindikalistë. Është një ndër çështjet kryesore hapësirat në lokalet shkollore.

Unë vij nga një shkollë Hasan Prishtina, është shkolla po thuaj se me një numër më të madh të nxënësve diku 2900 nxënës gravitojnë në atë shkollë, punojnë në katër ndërrime, fillon mësimi në ora 7.00 në 8.00 e përfundon në mbrëmje. Do të thotë aty jemi të detyruar t'i shkurtojmë orët ndërrimet e fundit, t'i bëjmë nga 35 minuta. Nëse e analizojmë pak a shumë meqë jemi të gjithë të arsimit, duhet çfarë suksesi do të jetë brenda asaj ore dhe çfarë cilësie do të ketë. Jemi detyruar disa kabinete që i kemi pasur qysh në vitet '78 kur është ndërtuar shkolla, e kemi pasur një shkollë me kabinet, një shollë shumë të mirë me pajisje kabinetike, jemi detyruar t'i bëjmë klasë, do me thënë kabinetet të bëhen klasë në këtë kohë pas 22-23 vjetëve është një gjë që nuk paramendohet tek ne.

Ndërsa, është interesante se këtu ka kapacitet për 900 nxënës është krijuar ajo shollë dhe kur vihet re tash te ndërtimi i shkollave tjera, shohim se ato shkolla nuk kanë salla, nuk kabinete, e mos të flasim për pajisje dhe ndërtohet ose një shtëpi private janë dëshmitarë në mund të ndërtojmë në vlerën e një shkolle, e që 8 vite do me thënë një shkollë nuk është gjetur e udhës mu ndërtuar në këtë pjesën tonë edhe për me ardhur deri te shkëmbim i numrit të madh të nxënësve, ndërsa këtu çka të zgjasim, do të përsëriten, jemi te kontrata kolektive siç e cekëm edhe më parë.

Te kontrata kolektive së paku të intervenohet dhe të zbatohet në ato nene të cilat veç janë nënshkruar nga Ministria edhe mos të anashkalohen sepse do të ketë pasoja që do t'i përjetojnë të gjithë, sepse është folur se disa nene do të zbatohen. Mandej jemi deri te ndonjë zgjedhje tjetër si për shembull shujta ose pagesa. Unë çka di këtu në Komunën e Prishtinës disa vende paguhen punëtorët, por në shumicën e vendeve jo, do me thënë kemi shumë raste që nuk paguhet rruga, nëse nuk paguhet rruga dihet se në barë të punëtorëve si shkon kjo punë. Por edhe një vërejtje ne si sindikatë ne e kemi te zgjedhja e organeve udhëheqëse të shkollave, të kenë kompetenca më tepër dhe të kë ligjshmëri edhe anëtarët e kolektivit që janë brenda shkollave. Mendoj se duhet të dëgjohet edhe zër i sindikatës, mendimi jo të hyjnë në votime ose të jep propozime ose kështu, por të dëgjohet zër i tyre gjatë pranimi të kuadrove.

Unë nuk do ta zgjasë më shumë, Ju përshëndes!

KRYETARI ENVER HOXHAI – Ju faleminderit shumë profesor. Fjalën po ia jap Profesor Nimon Alimusaj, masandej Nurani, profesoresha Sala Ahmet, profesor Ragip Zekolli, do të thotë radhën e ka Komisioni. I kisha lutur kolegët prej

Komisionit pa keqkuptim. Ideja ishte që dy orë të bisedojmë veç dy orë i kemi ofruar, por unë jam veç mosinter pares , absolut jo. Profsor Nimon Urdhëro.

NIMON ALIMUSAJ - Ju faleminderit të gjithëve dhe ju përsëndes. Unë për veti dhe sigurisht të gjithë anëtarët e Komisionit me padurim e kanë pritur këtë dëgjim publik që të njihen edhe më thellësisht me problemet në arsim, sepse me siguri do të mbahet një seancë ku do të jetë në rend të ditës çështja e arsimit, është kërkuar dhe ajo nuk është hequr, por është shtyre për një mbledhje tjetër.

Prej shumëve nga ju u fol na dhe ju – ju andej e na këndej dhe na u informuam kush jeni ju, po ju tregoj se të gjithë ne përveç këtyre dy zonjës dhe zonjushës janë ndihmëse juridike, të gjithë janë punëtorë të arsimit dhe mbi 90% vazhdojnë të punojnë në arsim, përveç ndonjërit që nuk ka mundur për shkak të udhëtimit siç jam unë, e kam humbur vendin e punës dhe nesër - pasnesër me siguri do të konkurroj në ndonjë shkollë se aty do të dal në pension me siguri.

Prandaj, secili prej nesh e njeh situatën në arsim. Tri janë çështjet më kryesore që dalin të gjithave pagat, cilësia, ligjet: unë e kam një studim këtu, varet qysh qëndrojnë se e përmendi z. Xhafer qysh qëndron në regjion, di se në Maqedoni për shembull pagat mujore në universitet që e përmende ti, janë prej 250 600, në Shqipëri janë prej 300 deri në 600 kurse në Kosovë prej 180 deri 600, do të thotë plafoni është i barabartë në regjion Maqedoni –Shqipëri e në Kosovë, në Universitet po them, kurse në universitetet private në Maqedoni nga 400-1200 shikoni tash ndryshimin në Shqipëri ora paguhet 50 euro, do me thënë rrogën e një mësuesi mundet me e marrë për 3 orë që i mban, kurse në Kosovë në universitetet private është 30 ora, i duhen nja 20 orë për me e pasur rrogën e një arsimtares, një punëtori në universitet atij .. Kjo është për t'u vajtuar, edhe pikërisht këto universitete private kanë dobësuar shumë ato publik, kjo dihet.

E pata lexuar diku një thënie të urët thotë: arsimi në dozë të vogël është helm, kurse në doza të mëdha, kurse në doza të mëdha është ilaç, tek ne gati se nuk ka ardhur arsimi në doza të vogla, do me thënë njëfarë helmi që nxjerrë kuadro plotësisht të pa kualifikuar. Dhe cilësia është një problem tepër pas pagave. Harrova të them te pagat, e tha dikush prej jush nuk është mirë në përqindje të kërkohej, unë e kam provuar nga të gjithë ata që merren me buxhetin e Kosovës me ditë se sa përend të buxhetit të Kosovës ndahen për arsim dhe kur nuk kam mundur me marrë përgjigje. Secili prej tyre që nga ministri e deri te këta që kanë drejtoritë të ndryshme kanë thënë nesër në faks ua dërgojmë në zyre të Komisionit, kur nuk na ka ardhur. Ajo përqindje nuk mund të përmirësoj. Më pëlqen ajo ide që e cakton fikse sa do të ketë edhe le te mendon arsimtari.

Te cilësia thash, është shtruar në helm, te ligjet ne si Komision i kemi vizituar edhe universitetet private edhe universitetin publik edhe shkollat fillor edhe të mesme, kemi parë mangësi të jashtëzakonshme që i theksuat ju, dhe ne si komision e kemi pasur në rend dite ndryshimin –amendamentimin e ligjit që e kërkuat ju shumë herë.

Unë po e marr një shembull: është bërë problematik huliganizmi që e përmendët ju, Ju të gjithë e dini se çfarë asi mase mund të marrë në shkollën e mesme – shkolla ndaj një huligani që vjen aty me revole e me thikë edhe po thërë si në Prishtinë edhe, e le më në shkollat rurale.

Mund ta largoj nga 5-6 e pastaj të organizojë orë plotësuese me ia kompensuar ato, kjo do të bëhet, por problem pse nuk e kemi bërë ne si komisioni ka qenë, sepse me Statusin duhet të ndryshohet shumë çka në ligje, edhe tash do të amendamentoj, tash ndoshta do t'i hyjmë megjithëse disa kanë qenë edhe z. Salë e tjerë se qysh tash ta bëjmë ose të pritët për një bravë që e tha dikush dy tre muaj ditë, kjo është absurditet. Nuk më pëlqej ajo që u bënë krahasime pse këtu më shumë ose më pak, ne si deputet deri në këtë muaj, në këtë që jemi e kemi pasur përafërsisht rrogën e udhëheqësve të sindikatave të huaja 465 €, ne nuk e bëjmë këtë krahasim që e bëjmë nëpër universitete në regjion, i bëjmë deputetëve. Në regjion është nga tre fish ose katër fish gjendja e deputetëve diku tjetër më e mirë se diku- diku.

Unë udhëtoj me autobus ose me një veturë private jo si u tha këtu, mos bëni krahasime me disa njerëz që punojnë në Qeveri. Unë kam rastin në fshatin tim Strellc që udhëtoj katër herë në javë e vijë këtu, që vi me autobus e kam shoferë që punon këtu që vjen me xhip të zi bash në fshatin tim. Këto janë gjëra që ndodhin tek ne. Mere me mend në KEK çfarë rrogash kanë, merrne me mend në postë po mos mendoni që deputeti ka një gjendje tepër, tepër të lakmueshme që po i lakmoni ishalla ju vjen radha edhe juve e behuni deputet. Vërtet neve na shqetëson gjendja e arsimit, si komision e kemi diskutuar për çdo ditë dhe kemi vërejtje pse ata që janë të obliguar nuk po na vijnë në mbledhjet e komisionit, ne e thirrëm javën e kaluar, lypëm Ministrinë nuk na erdhi dhe ne do të kërkojmë vazhdimisht, do të vendoset me siguri si rend dite gjendja në arsim se të gjithë në arsim çdo qytetar i Kosovës ka qasje, janë 400.00-500.00 nuk ka njeri që nuk e ka dikun ose nxënës ose tjerë, nuk mund të thuhet se ju jeni JU që na thatë ju që po duhet me ua qarë hallin se i keni rrogat të majme etj. etj. u faleminderit për këtë dëgjim!

KRYETARI I ENVER HOXHAI – Ju faleminderit z. Niman. Unë ju thash në fillim që ju mund t'i prezantoni në frymë sindikalistin, na në frymë parlamentare, veç profesori Niman e ofroi këtë qasje parlamentare. Nuran Malta

NURAN MALTA –Faleminderit shumë. Unë nuk desha me fol asgjë, por z. Bislim Bajrami pasi ka folur për paralele turke dhe boshnjake, desha me i sqaruar vetëm dy sende që i ka thënë, Besniku, po me falni, te libra edhe për nxënës ka folur sidomos unë për paralelet turke desha të flas, e sidomos në Prizren e në Mamushë ne asnjë klasë nuk e kemi përveç të Jaglenicës i kemi me 4-5 nxënës, sidomos në Mamushë i kemi 3 paralele e jo 4-5 nxënës, këtë veç desha me e sqaruar, dhe e dyta librat shkollorë – i kemi 15 libra nga Ministria të botuara në gjuhën turke, ndërsa prej Turqisë librat që na vijnë vetëm janë libra ndihmëse. Ju faleminderit.

KRYETARI I KOMISIONIT – Profesoresha Nuran Malta është ligjëruese në Departament e Orientalistikës në Universitetin e Prishtinës dhe anëtare e Komisionit

XXX

Profesor a bënë veç, jo replikë veç një sqarim vetëm le të shkon në secilën shkollë le të sheh me çfarë librash punohen, unë thash në paralele turke ka pak e në paralele boshnjake në secilën shkollë fillore kemi paralele me nga 4-5 nxënës.

NURAN MALTA - Unë vetëm fola për paralele turke, e caka këtu

KRYETARI ENVER HOXHAI – Besoj se u sqarua kjo çështje, profesoresha Sala Ahmetaj

SALA AHMETI – I përshëndes të gjithë të pranishmit. Shumica prej jush dhe nesh njihemi edhe më herët. Ne sot e kemi vështirë edhe të flasim sepse gjendjen në arsim e njohim dhe e dimë që është shumë e rëndë, por është mirë të përpiqemi që ta nxjerrim nga një situatë e tillë. Njëri prej kryetarëve të Shteteve të Bashkuara të Amerikës kishte anuluar një herë një takim shumë të rëndësishëm sepse donte dhe i kishte ardhur për vizitë mësuesi i tij. Kjo dëshmon për respektin që kanë të tjerët për mësuesin.

Unë mendoj, dhe kolegët e mijë të gjithë shumica prej nesh jemi punonjës të arsimit dhe kemi qenë dhe jemi idealist. Edhe për ne asnjë takim nuk ka qenë më i rëndësishëm dhe më emocionues se sa ky sot, prandaj mënyra e komunikimit mes nesh dhe jush do të duhej të ishte mënyrë e komunikimit të sinqertë sepse përkushtimi ynë është që të kontribuojmë aq sa mundemi në mënyrë që gjendja në arsim të ndryshoj. Disa prej nesh kemi qenë shumë të zëshëm edhe në diskutimet kur është bërë miratimi i buxhetit të Qeverisë së Kosovës dhe kemi kërkuar me këmbëngulje që buxheti për arsim të shtohet. Mundësi dhe shtigje ka gjithkund kur punohet seriozisht. Natyrisht, duhet të bëjmë edhe dallimin mes punës së deputetit dhe të Qeverisë.

Deputetët kryesisht përpiqen të shohin se si funksionon ligji. Ne, e përmendën kolegët nuk dua t'i përsërisë, i kemi vizituar disa shkolla, disa qendra të arsimit nëpër Kosovë dhe i kemi parë shqetësimet e këtilla çfarë po i shohim edhe sot nga ju, dhe do të përpiqemi që ndryshimet e nevojshme në ligje të bëhen, natyrisht shqetësim për ne është edhe cilësia arsim edhe statusi i palakueshëm i mësuesit edhe çështjet në mes të arsimit privat dhe arsimit publik sepse edhe kjo e ka dëmtuar shumë imazhin edhe të mësuesit dhe të arsimit. Unë nuk do ta zgjasë shumë sepse ne të gjitha ato që i thatë ju, i dëgjuam me vëmendje dhe e dimë se janë reale, por ne vetëm mund t'iu themi se këto shqetësime janë edhe tonat.

Do të përpiqemi të bëjmë atë çka ne mund të bëjmë në këtë moment dhe nuk varet gjithçka vetëm prej nesh. Kaq, ju falënderoj për vëmendje.

KRYETARI ENVER HOXHAI – Ju faleminderit profesoresha Sala. Profesor Ragip Zekolli

RAGIP ZEKOLOI –Ju faleminderit Kryetar, megjithatë unë mendoj që pas një bisede mjaft të gjatë, është pak e vështirë që të vijmë në përfundime, por do të na bënte nderë dhe respekt që në momente të tilla të punës sonë të përbashkët vërtet uji të shkojë në mulli dhe të sjellim rezultatin final në njëfarë forme sepse po shohim se vërtet gjendja në arsim është e rëndë nuk mund të përmirësohet a askush mua nuk mundet me më bindë që nuk ka forma alternative për ta tejkaluar këtë situatë, bile në këtë çështje e kemi biseduar edhe brenda nesh në Komision, kemi dal edhe në Seancë plenare me çështje të tilla, por është një diçka që vërtetë e dhimbshme po po e humbë rrugën. Do të hyjnë vetëm te një çështje që u përmend pa prekë pagat, po vërtetë kushtet e rënda të punës u përmend në tri, katër edhe pesë turme ka në Prishtinë edhe në qytete tjera.

Besoni që një diçka në shtatë qytetet e Kosovës është duke u ndërtuar nga një shkollë as që merret vesh ajo çështje, mund të marrë shembull Vranjevcin në Prishtinë apo diçka dhe të bëhemi të sinqertë para jush, megjithatë Qeveria i ka ndarë 5 milion më shumë në arsim, na vret Zoti mos me thënë për infrastrukturën edhe që janë 5 milion por nuk dihet ku do ta fillosh, në fazën përfundimtare janë ato që do të bëhen por është shumë shumë e dhimbshme, andaj cili do të ishte një propozim për mendimin tim që ne e kemi biseduar, e mendoj që është mirë me e gjetur vendin e juaj, do me thënë edhe në shkresën tuaj.

Ne patëm propozuar që, nëse vetëm shtohet një shtesë e veçantë në derivate të naftës sepse i harxhojmë përditë në duhan e në kozmetikë dhe të thuhet që këto mjete janë decidivisht për arsimin edhe infrastrukturën, shpresoj që sinqerisht brenda 5 viteve ne mund të dalim nga ajo situatë shumë e rëndë, andaj është mirë do me thënë në një teh i përbashkët i kësaj çështjeje që të shohim që të bëjnë presion në Qeverinë dhe të arrihet më shumë. Një brengë që e kam shumë të madhe që u përmend, por për fat të keq është në ligj. Pse nuk po vjen në debat publik çështja e arsimit? Ju lutem neni 12.3 Ministria është e obliguar që brenda vitit të raportojë në arsim, për arsimin në Kuvendin e Kosovës edhe atë çështje nuk ka nevojë as ta thotë opozita as ta thotë sindikati as dikush tjetër, por është një parametër ligjor që edhe kur është kërkuar, personalisht e kam thënë edhe në Seancë plenare këtë çështje që ajo duhet të debatohet, duhet të jetë publike dhe transparente sepse ndryshe nuk mund t'i tejkalojmë.

Pse është situata e dhimbshme? Ma besoni se unë jam më në kontakt me drejtorët komunal, po bëhem i sinqertë para juve, dhe ata e prekin një diçka ku është më së paku e dhimbshme. Këtu kisha me dal te parashkollorët që e përmendët, ne me ligjin që e kemi miratuar kemi thënë d.m.th. dhe katër vite do të thotë me mbërri që me pasur gjithë përfshirje në paralelet përgatitore nuk po them për çerdhe dhe për kopshte, por po themi për fëmijët e klasës pesëvjeçare që të përgatiten për këtë, edhe çka na ndodhë, na ndodhë një diçka që është shumë e dhimbshme dhe këto paralele fillojnë të mbyllen në mënyrë masive. Për fat të mirë informatat, ndoshta e ka bërë presioni janë, d.m.th që në terren kemi bërë shumë presion dhe nuk janë tue mundur me e vu gishtin vetëm këtu tani për momentin,

për ndryshe në vitin e kaluar ka qenë një çështje tepër e dhimbshme dhe një çështje e cila vërtetë është e kushtueshme. Çka nuk përmendëm asnjëri prej nesh që mendoj e ka vendin, e ka hapësirën edhe duhet gjithsesi ta kemi në agjendën tonë, është çështja e shkollave speciale. Më besoni unë mund të marrë shembull se ndoshta kemi pasur mundësi që të vizitojmë, që të shohim më shumë e të gjitha, por në vendet tjera këta fëmijë e kanë vetëm një kërkesë, cilat?

Ato që e thonë t'iu realizohet. Unë po ju marr vetëm një shembull në Kosovë që ne i kemi hapur 50 paralele, sivjet po bëjmë përpjekje t'i hapim 70 në përbërje të krasëve të bashkëngjitura që ata fëmijë me u njoftuar me njëri tjetrin, e dimë që janë në situata tejet të rënda, mirëpo ne praktikisht llogaritni që në Kosovë nuk e kemi një institut që merret me këtë çështje dhe krejt në fund kërkojë falje, pse kështu por, ta zëmë shkolla e Pejës nesër, pas nesër e ka një 25 vjetorin, shkolla e të verbërve, a llogaritni që ne nuk e kemi të unifikuar brenda tokave shqiptare alfabetin brajt.

Fëmija, i cili merr një vepër të Ismajl Kadaresë në shkrimin brajtë nuk mund ta lexojë në Kosovë. Çka duhet me na ndodhë më shumë para syve tonë, vetvetiu që të lëvizim, a është e lehtë për besë unë po bindem që nuk është, ndoshta kemi me pasur mundësinë dikush e përmendi çështjen e ndërrimit të vendeve dhe të gjitha to, po unë mendoj që kështu jemi më të fuqishëm, më mirë e kemi dy herë në tavolinë, se sa të jemi në rrugë e pastaj të jemi në çështje pa krye.

Andaj mua më ka pëlqye qëndrimi edhe i kryetarit në këtë rast po them menjëherë pa hezitim është pranua kjo çështje, por ju kisha lutë që të mos na kurseni, sepse ne përmirësohemi atëherë kur i kemi qëndrimet për juve po edhe të qitura në letër, sepse vetëm ashtu shpresoj që mund të bëhet, dhe krejt e fundit, unë po e marr vetëm një çështje e cila vërtetë u përmend shumë, çështja e teksteve shkollore.

Më besoni, me ligj thuhet neni 3 atje është menjëherë që tekstet janë gratis, i siguron do me thënë, Qeveria e Kosovës, në këtë rast për arsye se Ministria e financave i ka paret edhe ashtu është, po më besoni që vuajmë të zinj të ullirit, për ti sigurua 200 apo 300.000 €, vjet i kemi pasur 400.000 € për fëmijët e dëshmorëve, andaj është shtrua kjo nevoja e çështjes së ligjit, unë mendoj që ligjet që i kemi në fuqi, në këtë rast, te ligji i arsimit fillor edhe i të mesëm, ju lutem është duke na shkaktua më shumë dëm se sa zbatueshmëri dhe po e përfundoj me një studim të shkëlqyeshëm që është bërë në Gjakovë, unë jam marrë që 5 -6 ditë me te, më besoni që në shkolla të mesme neve na del mesatarja e nxënësit 30 mungesa. A me 30 mungesa na jemi ata të cilët i kemi largua.

Nxënësi që ka qenë në shkollë të mesme unë vetë kam punua, shumica prej nesh, do me thënë janë largua tani kemi një mesatare, po them, mesatare kushtimisht në komunën e Gjakovës lidhur me këtë çështje dhe ka ardhur koha do me thënë, që të ndërmarim diçka në këtë fushë, ju faleminderit! kërkoj falje nëse isha emocional.

KRYETARI:

Ju faleminderit profesor Ragip, profesoresha Naxhiye Doqi,

NAXHIJE DOQI: Ju faleminderit!

Është fakt se këto takime janë mëse të domosdoshme, ishin dhe janë mëse të domosdoshme dhe e kanë atë rëndësinë e vetë të pa-krahasueshme se çdo herë bisedat sjellin edhe suksese unë kujtoj se edhe kështu do të bëhet edhe me këtë takim që është organizuar me kërkesën e juaj këtu në Komisionin e Arsimit parlamentar. Me shumë gjëra pajtohem, sepse sindikata dëshiron mirëkuptimin për përmirësimin e gjendjes së arsimit përgjithësisht, do të thotë për përmirësimin e pagave, për përmirësimin e cilësisë së punës në arsim si edhe për funksionalizimin e ligjeve që kanë të bëjnë me arsimin dhe këto janë shumë të kërkuara, shumë të domosdoshme që duhet të realizohen.

Nuk dua të ju them se duhet të dimë se jemi në një pasluftë ende të rëndë, pas një lufte shumë të rëndë, shkatërruese dhe bërja e ligjeve ende nuk është finalizuar sa i përket çështjes së arsimit. Është bërë një ligj që funksionon, do të thotë për arsimin fillor dhe të mesëm, edhe i cili ligj për kohën ndoshta e ka pasur rëndësinë e vetë por, ligj që kërkon ende të avancohet, të amendamentohet, të plotësohet, dhe që do të bëhet në një kohë shumë të shkurtër me sugjerime që të vijnë, do të vijnë edhe nga ju, edhe nga sindikata.

Janë bërë edhe ligje të tjera, për arsimin, të cilat kujtoj se ende nuk kanë filluar funksionalizimin si duhet dhe jo se nuk i ka bërë parlamenti, ato janë bërë dhe janë amendamentua, janë nënshkrua, janë kryer nga Parlamenti, por ende nuk e kryejnë funksionin si duhet në praktikë. Ajo çka është e rëndë për ne, mos zbatimi i kontratës kolektive. Po të zbatohet kjo kontratë gjendja do të ishte ndryshe. Ndoshta nuk mund të themi plotësisht që nuk është zbatuar, pjesërisht është zbatua, krejtësisht një segment i saj, është realizuar edhe ai parcialisht.

Është e dhembshme kur ne nuk kemi, do të thotë në arsim nuk është sigurimi shëndetësor, po nuk është në tërësi, në tërë Kosovën, nuk është vetëm në arsim, sigurimi i pushimit shëndetësor për të gjithë punëtorët në Kosovë, është i pa definuar, jo vetëm në arsimin e Kosovës, edhe në këtë aspekt do të thotë kur vije çështja tek pushimet që nuk janë në rregull. Do të thotë dy javë është pushim me pagesë e tjerat janë pa pagesë, mirëpo edhe kur vijnë kemi reagime të atilla, tani unë po flas pak mbi konkretin, mbi asaj reales, me të cilën ndoshta shumë herë kam edhe ballafaqohem, edhe kur vijnë ato vërtetime të mjekut vijnë jo serioze, sepse nuk merren nga një vend i caktuar, por merren nga vendet e ndryshme, nga mjek të ndryshëm që mund të jenë edhe privat, që mund të jenë edhe që mund edhe të keqpërdorohen.

Prandaj edhe këtu vije ajo dilema, jo dilema pse duhet të krijohet, por dilema është pse vërtetë është e atillë dhe ato pushime dy javore nuk shfrytëzohen për siç është e kërkuar për disa ditë brenda tërë vitit për raste të jashtëzakonshme, por shfrytëzohen edhe me vend edhe pa vend, edhe do të thotë shfrytëzohen të lidhura dy javë.

Te arsimi parashkollor, është shumë dilemë, do të thotë breng e juaja edhe e jona, nëse e dini, do të thotë edhe nga drejtorët edhe nga një këshillë që merret me parashkollor dhe është kërkuar që të formohen paralelet parafillore, gjitha shkollat fillore, në mënyrë që nxënësit të kenë mundësi që të përgatiten edhe të jenë të barabartë me moshatarët e tyre që e kanë atë fat që të shkojnë në këto paralele parafillore.

Do të thotë nuk janë realizuar ashtu siç është planifikuar se nuk ka mjete, arsyeja është kjo, bile, bile nëpër Kosovë, disa që janë realizuar janë mbyllur për arsye të buxhetit. Disa komuna që kanë pasur mundësi kanë hapur me mjetet e veta kah i kanë gjet, ata gjanë gjendur, për ndryshe, gjendja është e tillë, pak më e mirë është në Prishtinë. Ajo çka na bënë të brengosemi pagat e ulëta të arsimtarëve që janë fakt të ulëta, por që në fakt janë pagat e gjithë punëtorëve që punojnë në institucionet publike dhe nuk është vetëm, është brengë po them prapë po nuk është vetëm tek arsimi, është përgjithësisht kjo në masë në tërë administratën publike, ajo çka,

(ndërhyrje kryetari) profesoreshë mund veç kjo është ora 4,20. kështu që sa më konkret.

Vazhdim: tani po e mbylli, është fjala për shkak të këtyre pagave të vogla është ajo më e dhimbshmja tek ne që nëpër shkolla organizohen kurse private me nxënësit e vetë. Arsimtarët mbajnë kurse me nxënësit e vetë, normal për ta përmirësuar njëjtën e tyre e ndoshta merr një formë si e arsyeshme por kjo është një dhembje e madhe, që na kushton, sepse arsimtari nuk realizon plan programin e vetë brenda orarit mësimor por e shfrytëzon atë që ta realizojë në orën private të organizuar me nxënësit e vetë, besoj se duhet të dëgjojmë se unë i dëgjova të tjerët por kjo është një dhembje, një dhembje që na kushton shumë. Organizimi kurseve private është dhembje sepse secilit nxënës i merret në muaj minimumit 20 €. Dhe kjo është në masë, jo vetëm tek një pjesë e shkollave por në masë të madhe kesi soji.

Ndërhyrje- nuk ma marr mendja që së bashku e ka përgjegjësinë për një gjë të tillë

Polemikë

Jo është pasojë por le ta dinë se edhe këtë e kanë të pranishme këtu, ashtu që është profesoresha Gjyllsen, profesoresha Remzije, profesoresha Dritë, Genci sigurisht do të folë,

Edhe një gjë kryetar ju lutem, tek drejtorët, tek pranimi i kuadrit u cekë këtu si vërejtje, do të thotë ndoshta ka ndonjë përjashtim, por nuk pranohet kuadri pa praninë drejtorit të shkollës. Drejtori i shkollës është përherë prezent, kur pranohet kuadri për shkollën gjegjëse. Shkollat mandej, (polemikë), mandej inventari nëpër shkolla, pati shumë vërejtje, inventari nëpër shkolla nuk është katastrofë, ka rrethoja nëpër shkolla, ka mjete, është fakt që mungojnë kabinetet por krejt

tragjike mos ta shohim, me gjithë kërkesat, me gjithë domosdoshmëritë, edhe për avancime të mëtutjeshme por krejt nuk është gjendja katastrofë seriozisht, ju falënderoj dhe kërkoj falje.

KRYETARI ENVER HOXHA:

Mund të them që qëndrimi është individual, nuk është i komisionit, ta keni të qartë prej fillimit, ne secili jemi deputet dhe mundë të themi çfarë të dom por ju jeni së bashku, kështu që i dimë përgjegjësitë që i keni, kësaj here sponionijmë që t'ju ballafaqojmë me problemet të cilat nuk ju takojnë juve.

Profesoresha Gjylshen

GJYLSHENE BERISHA:

Unë vetëm desha këtu ta përshëndes këtë takim të sotëm, që mua më duket mjaftë është produktiv, në kuptimin e asaj që kemi pasur edhe takime Komisioni i Arsimit, me sindikatën, po kanë qenë do tensione pak më të mëdha, se kanë qenë në funksion të ndaljes së grevave dhe më duket që ky takim i sotëm, ka nxjerrë në pah të gjitha ato probleme të cilat ballafaqohet rendi dhe për të cilat ne si komision meqë jemi edhe punëtor të arsimit, sigurisht që jemi të njoftuar me të gjitha.

Unë do të thosha te një vërejtje ku u tha sepse zonja Nuran paska shkuar, do të them kështu, në gjuhën turqishte apo boshnjakishte, apo serbishte, është e drejtë e fëmijës të shkollohet.

Është një nxënës, dy apo tre, pavarësisht prej numrit, mësimdhënësi do të paguhet, mirëpo nuk duhet të jetë në dëm të mësimdhënësve shqiptar.

Kjo është, të nxirret, ajo të vijë sikur ne jemi kundër p.sh. pse ata me tre nxënës, sepse edhe ne kemi raste ku kemi paralele të vogla, ku janë në viset rurale, ku kemi numër të vogël të nxënësve, mirëpo mësuesi paguhet. Kjo duhet të jetë në kuptimin e mbrojtjes së të drejtave të njeriut dhe respektimin e ligjit. Për të mos folur shumë, të gjitha këto, për të gjitha kemi njohuri unë do ta thosha që vërtet, arsimi duhet të jetë prioritet, jo t jetë në fjalë, jo me 5 milion €, sepse janë të pamjaftueshme për ti plotësuar të gjitha kërkesat që i ka arsimi, por në vazhdimësi, pajtohemi që në Kushtetutën një propozim shumë i mirë ishte që, arsimi të jetë prioritet, që nxënësi të ketë kënaqësi të shkojë në shkollë, që mësuesi të ketë kënaqësi që të shkojë në shkollë, që prindi të ketë kënaqësi të shkojë në shkollë.

Kur do ta arrin këtë, atëherë sigurisht që do ti kemi edhe këto takime edhe më miqësore mes nesh dhe mes të tjerëve. Ju faleminderit.

KRYETARI ENVER HOXHA:

Ju faleminderit profesoreshë, profesoresha Remzine Nimani

REMZIJE NIMANI:

Kryetar po e di që po ngutem por jemi vonua ne shumë, unë nuk e kam ndërmend të diskutojë shumë, vetëm zotëriu Zenel Zeka, pak te kontrata kolektive, disi, pushimin e lehonisë pak i dha prioritet. Mua nuk më duket as këtu që ka prioritet.

Tash në shkollën time ku unë punoj, dy arsimtare të mijat kanë shkua në pushim në fund të janarit dhe menjëherë pas feste duhet me u kthye, ato kanë marrë pagë 70%, deri tash, e nëse e vazhdojnë edhe tre muaj, marrin vetëm 40%. Dhe ato nuk kanë me çka të mbijetojnë, kanë kredi, kanë, dhe me 2 maj kthehen në punë. Do me thënë duhet me e lënë fëmijën tre muaj dhe me ardhur në punë.

Të gjithë jemi të interesuar që ky pushim të zgjatet, por unë jam befasua dhe pse gjithë këtë ndalesë, një herë 70, e mandej edhe më tepër, edhe nuk ju konvenon.

Te klasat me aftësi të kufizuara në shkollën time janë dy paralele, një është e para dhe e treta, ata nxënës kurrfarë prioriteti nuk kanë, se të gjitha klasat e tjera, nëse ato punëtore nuk vizatojnë vetë diçka ndonjë punim, absolutisht nuk kanë përparësi ata diçka pse janë me të meta, se unë e di që për ta është një fond i jashtëzakonshëm, edhe kanë një buxhet ata në vete, ai buxhet, nuk zbatohet edhe nxënësit mbesin sikurse të gjithë tjerët kështu në mëshirën e mësuesit.

E kisha dashtë që kjo edhe do të hyjnë në përmirësimin e ligjit, që këta nxënës të kenë, ti kenë do prioritete edhe më shumë, sepse unë e di që ka fonde të jashtëzakonshme për këta nxënës, por ato dikush nuk po i qetë në dritë, edhe nuk e di pse ata nuk po dua me ju mundua më shumë, por vetëm për të desha me thënë se ato punëtorët e mija sot një javë, nesër një javë kthehen në mësim, pse nuk paguhën 6 muaj por 3 muaj dhe atë me zbritje, ju faleminderit kryetar!

KRYETARI ENVER HOXHA:

Ju faleminderit profesoreshë shumë, profesoresha Drita e do fjalën,

DRITA ...

Meqenëse folëm gati të gjithë që jemi këtu, atëherë mos të bie që nuk po e bashkëndejmë të gjitha shqetësimet që u shtruan këtu,

Unë vetëm mundem me thënë se ky takim e ka një bukuri dhe e ka një domethënie të veçantë, e ajo është se jo që ne ndoshta nuk i dinim këto probleme, këto shqetësime, që ju i shtruat këtu, por lirisht mund të them dhe besoj se pajtohem edhe si Komision ndoshta nuk i ditëm deri në hollësira që i shtruat këtu dhe unë besoj që kjo do të ndikojë në vizionet tona që duhet t'i paraqesim si shqetësime të arsimit në çdo nivel dhe besoj që do të ketë sukses dhe anën tjetër desha të ju them edhe anën emocionale, më besoni se kah flisnit ju andej siç na ndatë në fillim, e ndienim dhembjen edhe ne kënde sepse ne të gjithë jemi në arsim, madje jo vetëm tani, por disa jemi tradicionalisht në arsim, dhe kjo e ka edhe atë domethënie që, i kuptojmë problemet deri në fund dhe natyrisht ne do të shfrytëzojmë mundësinë tonë të them tani të pozitës dhe të ligjit. Atë që është e mundur, dhe unë besoj se do ta bëjmë me përkushtimin më të madh.

Unë vetëm und të falënderohem për një takim të këtillë, dhe për sinqeritetin që e kishit ju, për hollësitat që i shtruat dhe besoj se do të gjejnë vend. Ju faleminderit!

KRYETARI ENVER HOXHA:

Ju faleminderit, profesoresha Dritë, profesoresha Myrvet

MYRVET...

Dëgjuam gjithë ato shqetësime që paraqiti sindikata e arsimit, të cilat nuk janë të largëta edhe për ne, edhe për familjet tona. Do të thotë edhe ne, paraprakisht para një viti dy, kemi jetua me ato dhe do të kthehemi aty. Për ata janë shumë shpirtërore dhe për neve, po dëgjuam edhe përshkrime të vendeve të punës, që të dy kategoritë tona do të thotë sikur të ngritëm në nivelin e përgjegjësive, tash po e them një thënie për.... se edhe e fundit ashtu, të gjithë do të jemi mirë dhe Kosova jonë do të jetë mirë, ju faleminderit!

KRYETARI ENVER HOXHA:

Ju faleminderit profesoreshë!, zoti Zeka,

ZEKA

E përmendi rastin ku ka ndoshta edhe keqpërdorime, edhe te dëshmitë e ndryshme nga mjekët, këto nuk përjashtohen normalisht, sepse nuk kemi të bëjmë këtu me dukuri por ka me raste. Por është shumë keq kur ka keqpërdorim të detyrës, apo ndoshta edhe me qëllim apo nuk di çfarë, sepse individit mundet me gabua, por institucioni nuk guxon me gabua.

Ju e përmendët që na bien edhe dokumente të llojllojshme që mund të jetë ashtu, por unë po ju përmend përpara, e kam këtu dokumentin, që e kanë fletë-lëshimin, që e ka lëshua spitali të nënshkruar me diagnozë të caktuar, të nënshkruar nga doktor Sllamniku, doktor Ibrahim, doktor Pustina. Do me thënë është shumë meritë. Ndërsa përgjigja është shumë qesharake dhe shumë banale, ndoshta është keq me thënë kështu, por njoftoheni se kërkesa e juaj për pushim pa pagesë në ruajtjen e vendit të punës është refuzuar si e pa bazë, çfarë baze duhet me pasur,

(ndërrhyrje – a ka arsye) –

Vazhdon:, absolutisht, do me thënë që kjo është ajo fjali edhe vërtetë kjo për te na, kushto që ta merr në dorë ose individit që tash ka mbetur pa punë, pikërisht kjo vjen prej Prishtinës, jo askund tjetër, po mos tija përmendi nënshkrimin kush e ka nënshkruar, sepse e dini kolegë i juaji është, por kjo po ndodhë, prandaj unë e përmenda si dëshmi, si rast që kemi edhe shumë një varg raste kësi soji, mos ti përmendi të tjerat, nuk po e zgjati shumë, edhe te zonja që e përmendi, unë e përmenda një ko.... tjetër, ne na është thënë edhe në Ministri të Arsimit, edhe në Qeveri, se ky nen me përpikëri zbatohet, pushimi i lehonisë zgjatë 6. muaj.

Këtë e kemi prej kabinetit të Ministrisë, edhe prej kabinetit të Kryeministrit, prandaj unë thash pak si në shaka, se në ndoshta vetëm ky nen po kjo dispozitë zbatohet për shkak se qeveritarët apo dikush tjetër i kanë gratë shtatzëna dhe dëshirojnë me i pasur 6 muaj, për asgjë tjetër jo.

Polemikë

KRYETARI ENVER HOXHA:

Ju faleminderit zoti Zeka, zoti kryetar urdhëro,

XXX

Ju faleminderit shumë zoti kryetar, të nderuar deputet, kujtoj se ishte një dëgjim publik shumë me interes, interesi ynë ishte që ne ti prezantojmë kërkesat tona para juve, unë nuk mund ti ndajë në ne dhe ju se jeni të gjithë punëtor të arsimit, e ndieni dhe bashkëndjeni me ne tërë këtë situatë të rëndë, qëllimi dhe qëndrimi ynë është që ju të ndikoni dhe të impononi qëndrimet tuaja, para Qeverisë, se Qeveria është e jona, nuk është e ndonjë shteti tjetër, edhe të kërkon në përmirësimin e pozitës materiale dhe ndryshimin substancial të sistemit të arsimit publik në Kosovë.

Unë po i referohem fjalës së koleges Gjylshene, profesoreshës së nderuar, kur thotë se kemi njohuri, por kemi njohuri faktikisht por duhet ndryshuar gjendjen dhe kush janë ata që duhet ndryshuar, nëse ne nuk merremi vesh, atëherë punët vuajnë diku tjetër dhe me qëllim që mos të ndodhë ajo që ka ndodhur, do të ishte mirë që shumë gjëra të ndryshojnë, së pari buxheti ka kaluar te ju shumë shpejtë, brenda dite, nuk di si keni arrit ta aprovoni atë buxhet, me nxitim, do me thënë lehet deri në ditën e fundit ose nuk di unë kur janë ditët e fundit, në buxhet në kohën kur bisedohet për buxhet nuk është përfaqësuesi i sindikatës, më mirë të ballafaqohemi atje se pastaj kjo është një dobësi që ndodhë në institucionet tona dhe unë po kërkoj që vërtetë ato të bëhen vërtetë në mënyrë institucionale, të pyeten ose të konsultohen ata që duhet konsultuar dhe mos të vije deri te problemet që mund të ndodhin.

Prandaj ne jemi ata që mund të bisedojmë, ne jemi ata që mund të ndikojmë, ju duhet të jeni ata që ta thirrni në interpelancë edhe Ministrin e Arsimit, por edhe Ministrin e Ekonomisë dhe Financave dhe të gjithë ata që duhet të vijnë dhe të japin sqarime për detyrat, obligimet dhe përgjegjësitë e tyre. Nëse kjo nuk ndodhë, nëse gjatë një viti një herë Ministri i Arsimit duhet të vie dhe të prezanton aktivitetin, punën, dobësitë, rezultatet, pse ne të jemi ata nxitësit që ata të vijnë, ne po kërkojmë, që kjo letër e hapur të kalojë në parlamentin e Kosovës, dhe ju të jeni ata që duhet ta shtroni çështjen, të kërkon me ngulmë që Qeveria vërtetë të japë llogari parlamentit dhe të japë të gjithë punëtorëve të arsimit, nuk u morëm me sektorin civil, por u morëm me çështjen e arsimit, ne urojmë që edhe të tjerët bashkë me ne ta ndryshojnë gjendjen.

Ne jemi këtu të bisedojmë për çështjen tonë, se po të bisedojmë për shërbyes tjerë civil, me siguri kanë me na e zënë për të madhe dhe se kush ju ka thënë juve të merreni me këtë punë. Do të merremi me punën tonë.

Prandaj, përfundimisht ju falënderoj shumë përbetë dëgjim edhe pse ua kemi marrë kohën më shumë, do me thënë nuk ishim korrekt këtu fare, por thashë se ky deformimi profesional po e bëka të vetën, dhe çka i kemi do mësues të vjetër këtu, edhe Bëlimin edhe Aliun edhe send, që nuk dinë të ndalen por, megjithatë,

Polemikë

Pra 45 minuta e fundit por, edhe pse e kanë shkurtuar orën 30 minuta por megjithatë ju falënderoj për zemërsisht dhe kërkoj edhe një herë që të jeni aktiv që çështjen e arsimit në parlamentin ta trajtoni me kompetencë dhe të kërkonit në mënyrë kategorike që ndëja të ndryshohet, nëse nuk ndryshohet na jepni rastin që ne ndoshta nuk po them fortë seriozisht se atë nuk e bëjmë, por ti përdorim mekanizmat sindikal që nuk do të kishim dashur ti përdorim. Do me thënë t'i shterim të gjitha ato mundësitë, prandaj edhe një herë në emër të ekipit së bashku të ju falënderoj për zemërsisht për momentin,

Polemikë

XXXX

Kërkesa jonë ka qenë dhe është e shkruar, që mundësisht ta bëni një kërkesë Kryesisë apo Kuvendit që, për këtë gjendje të referojë përfaqësuesi së bashku me eprorin, e dimë që ka vështirësi, por megjithatë kishim pasur dëshirë të ja japin mundësinë që në Kuvend ta themi fjalën tonë.

Vazhdon -kryetari :

Ose në se ajo nuk bëhet, ndoshta vështirë bëhet, bile të na jepni mundësinë që të ju adresojmë një letër të shkurtër, jo kaq të gjatë, e cila letër do të ju ndahet të gjithë deputetëve. Kemi të drejtë të ju ndahet por nuk, është letra e hapur dhe do të ishte mirë që kjo punë të përfundojnë në mënyrë të suksesshme pikërisht për sistemin e arsimit publik në Kosovë. Ndërhyrje) vëzhgues po se po, vëzhgues nuk mund të na ndalin, por vëzhgues është atje diku larg ngjarjes, se unë kamë qenë vëzhgues me zotin Bislim por vetëm kemi dëgjua, edhe një herë ju falënderoj nga zemra dhe faleminderit shumë.

KRYETARI ENVER HOXHA:

Zoti kryetar Ju faleminderit shumë, ndërhyrje, a bënë një garanci prej neve mësuesve, se nëse na e bëni rrogën 1000 €, kur nuk keni me na e ndie zërin.

KRYETARI ENVER HOXHA:

Profesor më duket fjalja ke më tepër kushtore, a lidhore?, lidhore ke mirë,
Polemikë,

Zoti kryetar të faleminderit, prej jush personalisht dhe prej të gjithë përfaqësuesve të sindikatës për këtë dëgjim publik, na si Komision për arsim në kuadër të përgjegjësisë dhe fuqive tona politike, kompetencat që kemi, kemi synua herë pas here ta ngremë çështjen e arsimit, mirëpo, kuptohemi që nuk jemi i vetmi komision në Kuvend të Kosovës, mua më duhet vetëm me qëllim që kur flasim për gjendjen materiale të arsimit dhe të mësimeve që përmendi një fakt që, Komisioni ynë kur është miratua buxheti për këtë vit dhe kur është pa që prej vitit të kaluar kanë mbet 76 milion €, suficit në emër të Komisionit.

Ne kemi bërë kërkesë që gjysma e këtij buxheti ti dedikohet arsimit, është shkresë zyrtare e cila është dhënë Kryesisë së Kuvendit dhe Qeverisë së Kosovës, për këtë mbetje të buxhetit prej vitit të kaluar dhe mbi të gjitha ministrin të financave, ku unë personalisht kam folur edhe Ministrin e Financave dhe Ministrin e Arsimit që ta shohin një mundësi a do ta marrin seriozisht kërkesën prej Komisionit i cili është shumë partiak, nuk është vetëm i një partie.

Sa i përket takimit të sotshëm ne do të ia bëjmë një shkresë Kryesisë së Kuvendit rreth caktimit të një seance të shpejtë të ngutshme për gjendjen në arsimin fillor, të mesëm, po kuptohet që mundë të bisedohet edhe për arsimin e lartë sipas nevojës, do të dërgojmë transkriptin e këtij takimi, meqë ky takim do të thotë incizohet dhe ka mundësinë Kryesia e Kuvendit, dhe profesori Niman dhe unë do ta takomë edhe Kryetarin e Kuvendit, me qëllim që ta informojnë për takimin që kemi pasur, ndërsa kuptohet unë do ta përcjellë edhe kërkesën e juaj që ju të referoni para deputetëve, meqë është përgjegjësia ime që ta përcjelli më tutje por është masandej çështje e Kryesisë së Kuvendit, se kush fletë apo jo.

Janë disa karrige të Ekipit të Unitetit të gatshme, a do të lejon Kryesia e Kuvendit që të uleni ju në karrige të Ekipit të unitetit, është çështje e tyre, e definitivisht ne juve ju shohim në cilësinë e njëjtë si në cilësinë e Ekipit të unitetit, tashi procese politike juve për arsimin në Kosovë, derën e keni të hapur në Komision, për çdo gjë që vërtetë ju premtojmë.

Komisioni çdo herë ka qenë në dispozicionin e juaj, shpeshherë si deputet, kemi qëndrime të caktuara, por kjo është në frymën e parlamentarizmit, na shihemi shumë gjatë në frymën e sindikatës, kështu që besoj që për çdo gjë që kemi thanë, do ta keni edhe, besoj që e gjejmë mirëkuptimin tek ju. Ju faleminderit edhe një herë, besoj që do të ju informojë së shpejti për punë të seancës se kur do të mbahet, masandej, grupet parlamentare, sipas fuqisë së deputetëve, sipas fuqisë janë në gjendje ata që e formësojnë debatin se kah do të lëvizë.

Dëgjimi përfundoi në orën _____